



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:007991

Datë: 03.01.2020

Numri i dokumentit: 00746020

P nr.106/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PEJE, Departamenti i Krimeve te Renda, ne trupin gjykues te përberë nga Gjyqtaret: Lumturije Muhaxheri kryetare e trupit gjykues – gjyqtareve, Sami Sharaxhiu dhe Muse Povataj anëtar, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shpresa Kërnja, në çështjen penale kundër të akuzuarit H. K. nga, për shkak të veprës penale keqpërdorim i detyrës zyrtare nga neni 422 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, PP/I.nr.301/16 dt.10.11.2017, në seancat e shqyrtimeve gjyqësor publike të mbajtura nga data 04.12.2018 e gjerë me dt.27.11.2019, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Haxhi Sinanaj, të akuzuarit H. K. dhe mbrojtësit te tij avokat Gëzim Kollqaku nga Peja, sipas autorizimit, përfaqësueses se autorizuar te dëmtuarës Av.Drita Sopi Gashi nga Prishtina, me dt.02.12.2019 murr dhe me dt. 03.01.2020 përpiloi këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari H. K. , i lindur me, në ku edhe ka vendbanim të përhershëm ne Rr., , nr.5, i biri i N. dhe F. , e gjinisë Zh., i martuar babë i tre fëmijëve , ka te kryer Fakultetin e Biznesit me profesion administrim biznesi , i punësuar ne Kuvendin Komunal ne Peje, Zyra për Komunitet dhe Kthim, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar.

ESHTË FAJTOR

Për shkak se:

Ne periudhën kohore nga fillimi i muajit qershor 2016, ne mënyrë te vazhdueshme e gjere me dt. 18.10.2016 ne, duke qene ne pozitën e zyrtarit për komunitete dhe kthim ne Komunën e, tejkalon autorizimet e tija ligjore me qellim te përfitimit te dobisë pasurore për vete dhe personat tjerë , ne atë mënyrë qe përmes programit ,,, program ky i cili shërben për vjedhjen e fjalëkalimeve , merr fjalëkalimin e shfrytëzueses se kompjuterit M. L. dhe fjalëkalimin e shfrytëzuesit te kompjuterit G. T. zyrtar për Komunitet dhe Kthim ne Komunën e, e duke shfrytëzuar kompjuterin e këtij te fundit , por edhe kompjuterin e tij personal , përmes programit,,, hyn ne sistemin kompjuterik te M. L.-zyrtare për tatim ne prone ne Komunën e, ashtu qe gjate periudhës se lartcekur ka arritur ti shlyej obligimet tatimore te dëshmitareve , J. K., E. A., A. K., R. K., A. K., N. B., V. M., E. A., dhe V. B.,

duke ju sjelle te njëjtëve, përfitim pasuror te kundërligjshëm , e duke i shkaktuar dem buxhetit te Komunës se ne shume prej 18.275.98 €, ndërsa ne fillim te muajit qershor 2016, nga dëshmitari B. G., merr shumen e te hollave prej 170 €, për te shlyer obligimin e tij tatimor për gjashtëmujorin e pare te vitit 2016, por te njëjtit tatimin ne fjale nuk ia shlyen, ndërsa qe te hollat ne mënyrë te kundërligjshme i kishte përvetësuar për vete.

-me çka ka kryer veprë penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 te të KPRK-së

Trupi gjykues me aplikimin e neneve 7, 8,17, 21,31, 41, 43, 45, 46, 62 par.2 pika 2.3 nenit 65, 73, 83, nenit 428 par.1, të KPRK, si dhe neneve 359, 360, 365, 366, 450 të KPPRK, të akuzuarin e

G J Y K O N

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashte) muaj , në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. 19.10.2016 e gjere me dt.18.11.2016 dhe arrest shtëpiak nga dt.18.11.2016 e gjerë me dt. 18.12.2016, e të cilin dënim do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumen prej 100 (njëqind) euro dhe në emër të paushallit gjyqësor shume prej 50 (pesëdhjetë) euro, kurse në emër të taksës së programit për kompensimin e viktimave obligohet të paguaj shumën prej 50 € (pesëdhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike i udhëzoi ne kontest te rregullt civilo juridik

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngrit aktakuzë, PP/I.nr.301/16 dt.10.11.2017, kundër të akuzuarit H. K. nga, për shkak të veprës penale keqpërdorim i detyrës zyrtare nga neni 422 par.1 të KPRK-së .

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në të cilën, të akuzuarin e ka njoftuar me të drejtat e tij nga neni 323 të KPPRK-së, si dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurores së Shtetit PP/I.nr.280/2013 dt.25.03.2015, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe duke vepruar në kuptim të nenit 325 të KPPRK-së, të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë. Me këtë rast, gjykata të akuzuarin e ka udhëzuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë në kuptim të nenit 248 par.1 pika 1.1,1.2.1.3 të KPPRK-së, kështu që i akuzuari nuk e pranoi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë, ashtu që gjykata shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me procedurën e provave .

Prokurori i shtetit , në fjalën e tij përfundimtare të parashtruar me shkrim, fillimisht bëri precizimin e diapozitivit të aktakuzës, te përshkruar si ne diapozitiv te këtij aktgjykimi, dhe pasi që bëri elaborimin e provave një nga një, ka deklaruar se nga provat e administruara është vërtetuar se i akuzuari H. K. ka kryer veprën penale Keqpërdorim i detyrës zyrtare , andaj i propozon gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, komfor nenit

64 te KPRK-se , t,ia shqiptoj dënimin plotësues urdhrin për kompensimin e dëmit prej 18.275.98 € te shkaktuara Komunës se

Në fjalën përfundimtare, përfaqësuesja e autorizuar e te dëmtuarit, deklaroj se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit .

Mbrojtësi i të akuzuarit, në fjalën e tij përfundimtare deklaroi, se me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, deklaroi se aktakuza e ngritur nga prokurori është shume konfuzë dhe e pa mbështetur në asnjë prove materiale që do ta mbështeteshin dyshimin e bazuar se veprimet e te mbrojturit te tij formojnë figurën e veprës penale për të cilën akuzohet nga këto arsyeja, në diapozitiv ceket se i akuzuari veprimet inkriminuese i ka kryer nga muaji korrik e gjere me dt. 18.10.2016 edhe pse me dt. 22.09.2019 te akuzuarit i është konfiskuar shtëpiza e kompjuterit nga hetuesit e krimeve ekonomike ne Peje, gjithashtu në diapozitiv ceket se i akuzuari përmes programit ,,, program i cili shërben për zbulimin e fjalëkalimit te shfrytëzuesit te kompjuterit te M. L. zyrtare për tatim ne prone ne Komunën e , dhe nga kompjuteri i tij e përmes programit ,,, program i tatimit ne prone futet ne sistemin kompjuterik te zyrtares M. dhe ne këtë mënyrë arrin ti shlyej obligimet tatimore. Shton se pasi qe programi ,,, është gjetur ne kompjuterin e zyrtares M., e sipas ekspertit te TI-së A. K.ky program instalohet drejte për drejt ne kompjuter, si dhe duke pasur parasysh se zyrtarja M. ka deklaruar se nuk ka njohuri rreth këtij programi e as për çka shërben e asnjëherë këtë program nuk e ka instaluar ne kompjuterin e saj si dhe duke pasur parasysh deklarimin e saj se i akuzuari nuk ka qene ne zyrën e saj , dhe se i njëjti vendin e punës e ka ne një ndërtesë tjetër nga ajo ku e ka zyrtarja M. , parashtrohet pyetja se si i akuzuari e instaloi këtë program kur thuhet se ky program ne kompjuterin e zyrtares është instaluar dhe de instalu disa here, atë here me sigurinë me te madhe nuk ka qene këtu i mbrojturi i tij por dikush tjetër.

Dihet fakti se është ekzaminuar edhe kompjuteri i zyrtares M. dhe pas ekzaminimit është përpiluar raporti i te gjitha aktiviteteteve te bëra përmes programit,,, për periudhën janar e gjere ne muajin tetor 2016, sipas mbrojtësit nga ky raport i aktiviteteteve te programit ,,....., shihet se ka pasur aktivitete ne programin ,,, ne kompjuterin e M. edhe gjate periudhës qershor , korrik, gusht kur zyrtarja M. ka qene dy here ne pushim vjetor, dhe një here ne udhëtim zyrtar qe do te thotë kompjuteri i saj ka qene i ndalur e qe sipas ekspertit te TI-së nuk ka shanc te ndërhyhet nga një kompjuter ne kompjuterin i cili ka qene i fikur, bazuar ne te gjitha te cekurat me larte i mbrojturi i tij nuk ka pas mundësi te shkoj ne zyrën e M.me ndez kompjuterin e me ndërmarr aktivitete ne programin ,,, dhe sipas mbrojtësit te tera këto ndërhyrje janë bere nga ndonjë person tjetër qe ka pasur qasje ne kompjuterin e M.s.

Gjithnjë sipas mbrojtjes eksperti i programit 2 E. M. ne një nga pyetjet e parashtruara nga gjykata është përgjigjur se zyrtarët komunale te tatimit ne prone nuk janë te pajisura me linkun e qasjes nga jashtë te njëjtit janë te njoftuar vetëm me linkun e qasjes nga brenda rrjetit qeveritar , qasja nga jashtë aplikohet për aplikacionin për anketim ne tërsi te cilin e përdorin anketuesit e zyrave komunale te tatimit ne prone. Prokuroi i çështjes në fjalën përfundimtare bëri plotësimin e dispozitiviti të aktakuzës bazë dhe atë në pjesën e periudhës së kryerjes së veprës penale duke cekë se tani i mbrojturi i tij veprën penale për të cilën dyshohet e paska kryer nga fillim i muajit qershor 2016, e deri me dt.18.10.2016, duke mos llogaritur provën për të cilën prokuroi u ftua në këtë fjalë përfundimtare dhe atë ekspertizës financiare të ekspertit Ukë Sadiku, e cila ekspertizë është bërë për periudhën kohore prej dt.14.07.2016, e jo nga fillim i muajit qershor, gjithashtu prokurori mbeti ende se mbarimi veprës penale

paska qenë me dt.18.10.2016, edhe pse ne gjithë e dimë se kompjuteri i H. është konfiskuar me dt.22.09.2016, donë me thënë 28 ditë më parë.

Ne fund shton se trupi gjykues para marrjes se vendimit duhet te ketë parasysh se i mbrojturi i tij nuk është person zyrtar me plotë përgjegjësi edhe po të kishte qenë person zyrtar i njëjti nuk e ka kryer veprën penale, nga se personi zyrtar duhet ta kryej veprën penale në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive të tija.

I akuzuari në fjalën përfundimtare deklaron, se ne tersi e përkrahë fjalën përfundimtare te mbrojtësit te tij.

Ne mbrojtjen e tij deklaron se pas luftës ka punuar në një komision për vlerësimin e dëmeve nga lufta, pasi që është shuar komisioni pas 1 vit e gjashtë muaj është transferuar në Drejtorin për Financa në të cilin sektor ka punuar edhe para luftës , kurse pas luftës nga viti 2002 deri në fillim të vitit 2010 dhe ne këtë drejtorat ka punuar në grupin e formimit të tatimit në pronë pranë KK-....., prej 2010 është transferuar në Drejtorinë për Kthim dhe Komunitetet dhe atje ka punuar deri në maj të vitit 2012, nga kjo kohe është transferuar në zyrën e prokurimit në KK-Pejë, dhe ka punuar deri në fund të vitit 2015, ku pastaj prapë është transferuar në zyrë për kthim dhe komunitete ku edhe ka punuar deri me dt. 22.tetor.2016 ku është suspenduar deri ne një vendim te gjykatës. Më kompjuter është pajisur në fund të muajit maj 2016, kompjuteri te cilin ia sillen ishte i përdorur. Ne kompjuterin e tij asnjë here nuk e ka instaluar programin Ne zyre ka punuar me G. T. dhe Sh. R. te komunitetit rom dhe asnjë here nuk ka punuar në kompjuterin e Gani Toskës, veç se ndonjëherë se bashku kane shikuar rezultatet sportive, nuk kishte mundësi me pas qasje ne kompjuterin e tij nga se nuk e ka dite passwordin e tij andaj edhe nuk është e vërtetë se e ka keqpërdorë kompjuterin e Ganiut . Deklaron se është e vërtetë se ne prezence te G. T.ka fut një USB-i për te shikuar filma dhe arsyeja se pse ne këtë USB-i thuhet se ka qenë i regjistruar një Word Dokument një link HTTP/10.41.0.74:59074 “.....” loggin In.JSP? login error, është se ne këtë folder ku kanë qenë filmat ka qenë edhe ky Word Dokument, i regjistruar në Word Tekst Documents. Sa i përket programit, ka punuar shumë pak me sistemin e ri apo me linkun se në vitin 2010 ka dal në zyrën për kthim dhe komunitet. Këtë link në vitin 2009, apo fillim 2010, ju kane jap nga Departamenti i Tatimit në Pronë Prishtinë, e kanë vu dhe nuk ka mundur me përdor askush ka mbetur i pa përdorur i vdekur. Sipas ekspertit që ka treguar ka qenë link i koduar, këtë link ua kanë qit dhe u kanë jap ata te TI-se nga Departamenti i tatimit në pronë i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Financave Prishtinë, në të vërtetë ky link u është vu në Word, por ky e ka ruajtur në USB-i dhe si arsyes pse e ka bart në USB-i, është se rastësisht mos të priset kompjuteri dhe gjatë rregullimit mos të humb.

Deklaron se në kohen kur është instaluar linku prej Ministrisë së Financave Prishtinë në të njëjtën kohë ju kanë dhënë USB-in nga Kuvendi Komunal dhe atë në prezencë të Drejtorit M. R.. Ne këtë periudhe kohore ne sistemin kane punuar edhe persona tjerë dhe për këta persona nuk ka njohuri se a ju është dorëzuar USB-i me linkun “.....”, dhe ky link i ruajtur ne USB-i edhe në kohën kur është suspenduar nuk është aktivizuar asnjëherë .Sipas te akuzuarit me qene se ne këtë link ne fund shkruhet loggin – error, dhe me qe te njëjtin nuk e ka përdor as një herr, nuk është ne dijeni a ka pas mundësi teknike që me këtë link të bëhet ndërhyrja në kompjuterin tjetër në ndonjë program. Të njëjtën USB-i pasi ka kaluar në drejtorin tjetër e ka përdorë bashkëshortja e tij për incizim te filmave-serive televizive. Nuk ka ndie përgjegjësi për me e kthy atë USB-i, të njëjtën nuk e ka kërkuar kurrkush i njëjti ka qene diku 2 giga.

I akuzuari e mohon te ketë ndërhyrë në kompjuterin e M. L. gjithashtu e mohon te këtë qene ndonjë herë ne zyrën e saj. Nuk ka ide se si fotot e disa qytetarëve te rëndomtë dhe disa zyrtarëve te komunës kane mundur te regjistrohen ne telefonin e tij

B. G.n e njuh nga Shërbimi Ushtarak, dhe nga përfundimi i ushtrisë te njëjtin nuk e ka takuar asnjë here, nuk ka njohuri se çka punon i njëjti. Nuk është ne dijeni se djali i tij a i ka mbajtur orët e provimit për veture te dëshmitari B., pasi qe këtë provim ,djali ia ka bërë befasi miku i tij dhe se nuk ka njohuri ku e ka regjistruar. I akuzuari nuk ka njohuri pse dëshmitari ka deklaruar ashtu siq ka deklaruar ne deponimin e tij, por mendon se e ka mësuar dikush me rëndu nga se me të nuk ka pas asgjë personale.

E mohon faktin se ne kompjuterin e tij ta këtë pas te regjistruar programin, nga se ky program instalohet përmes Departamentit të Financave Prishtinë. Nuk ka njohuri se kush i ka privilegjet administrative ne sistem qe nëpërmjet uzer name dhe passwordit valid mund te ketë qasje nga jashtë ne moduln 1, përmirësohet duke shtuar se privilegjet e administratorit i ka vetëm TI-ja komunës e askush tjetër.

Ne mbrojtjen e tij për veç tjerash deklaroi se diku ne muajin korrik te vitit 2016 ne zyrën e tij ka shkuar TI-ja komunës L. D., ka kërkua nga ky qe te largohet dhe te ja lëshon kompjuterin se ka me punuar diçka ne te , dhe nga ajo kohe kompjuteri nuk i ka punuar mire.

Sa i përket aftësive te tija teknologjike me kompjuterin, i akuzuari deklaroi se ne këtë drejtim nuk ka te kryer asnjë kurs për kompjuterë, por ka mbajtur disa trajnime para vitit 2009 si gjithë zyrtarët e komunave në departamentin e tatimit në pronë. Kurse sa i përket sistemit te digjitalizuar të evidentimit të hyrje daljeve të stafit të Komunës, për here te pare për këtë sistem ka dëgjuar nga dëshmitari TI-se së Komunës dhe nga shkresat e lëndës.

Deri sa ka punuar ne Komunë, furnizimin me pajisje kompjuterike dhe teknike e ka bërë firma “.....” me pronar N. M., dhe si serviser ka punuar edhe djali i tij M..

Arsyeja e transformimit te tij ne vitin 2010 nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa ne Drejtorin për Komunitet dhe Kthim, është se ne drejtorin ne te cilin ka punuar ne tatimin ne prone ka qenë një problem ku janë keqpërdorë 4 passworda për vendimet që lëshohen për regjistrim te veturave për 10 euro, është keqpërdorë passwordi i tij dhe zyrtareve H. A., M. R. dhe i M. T., edhe pse është keqpërdor edhe passwordi i tij, drejtoresha ne atë kohë A. G., e ka konsideruar si të dyshuar dhe rastin e ka lajmëruar në polici dhe pas hetimeve ne prokurori janë pushuar hetimet ndaj tij, qëllimi i drejtoreshës ishte qe ne pozitën e tij ti sillte personat e vetë dhe ne këtë kohe ka qene i suspenduar për 6-7muaj, me pagesë prej 50 %.

Është e vërtetë se edhe ne vitin 2014 deri sa ishte duke punuar ne zyrën e prokurimit ka qene i dyshuar për çështje te njëjta dhe ka qene i suspenduar për 3 muaj dhe me qe nga ana e prokurorisë nuk janë ndërmarr hetimet ndaj tij , nga kryetari është kthyer prape ne pune.

E pohon faktin se ne zyrën e tij policia ka konfiskuar një kompjuter KKP1/382 kodi 238, ngjyrë e zezë dhe 2 telefona celular, kurse në shtëpinë e tij nga policia janë konfiskuar 3 CD, nj llap top të markës HP, dy hard disqe, dhe se te njëjtat kane qene te tija. Laptopin përveç tij e kane përdorë edhe fëmijët

Gjykata gjate shqyrtimit gjyqësor ka administruar këto prova, mbrojtjen e te akuzuarit ne te gjitha fazat e procedurës penale, janë dëgjuar dëshmitarët, M. L., G. T., J. A., B. G., F. J. , A. K. , E. A., F. M., R. B., M. M., ekspertet e TI-se A. K., Sh. S., (prokurori ka hequr dore nga

dëgjimi i dëshmitareve Q. S., N. B., J. K., V. B.), sipas propozimit të mbrojtësit janë dëgjuar dëshmitarët, L. D., E. K., V. B., janë dëgjuar ekspertët, eksperti financiar Uke Sadiku, dhe eksperti E. M. Zëvendës Menaxher, i projektit për zhvillim të TI-se Projekti, ka administruar këto prova materiale, janë lexua, raporti fillestar i incidentit me nr.2016-DE-300 dt.26/-8/2-16, raporti i hetuesit policor F. J., raporti njoftues i përpilua nga drejtori i financave J. A. dt.26.08.2016, vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve dt.22.09.2016, vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve dt.19.10.2016, vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve të zyrtares M. L. me nr.2016-DE-300 dt.17.10.2016, aktvendimi mbi shfrytëzimin e pushimit vjetor të nëpunëses M. L., vërtetimi i të punësuarit këtu pandehurit H. K. për transferim në vendin e punës lëshuar nga KK-Pejë, procesverbali mbi bastisjen e shtëpisë dhe zyrës së akuzuarit H. K. dt.19/10.2106, procesverbali mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve nga S. C.– Zyrtar për komunitet dhe kthim në KK-Pejë, raporti – lista e obliguesve tatimor që u janë shlyer borxhet dhe evidencat e hyrje daljeve në objektet e KK-Pejë, për vitin 2016 për tre persona (dëshmia në CD 1), raporti nga Departamenti i tatimit në Pronë për KK-Pejë, për vitet 2014, 2015, 2016, dëshmia në CD-1, raporti i, raportit i Banke, raporti i të trija për xhiro llogarinë e të akuzuarit, (CD-1 – gjithsejtë 18 CD), raporti i faturave në pronë dhe kartelat e tatimit për vitin 2016, për obliguesit tatimor të cilëve u janë shlyer borxhet nga i akuzuari, raporti i Kompanisëpër thirrjet hyrëse dhe dalëse dhe raporti i kompanisëpër thirrjet hyrëse-dalëse. Shikohet dëshmia CD-ja mbi dëmin e shkaktuar buxhetit të Komunës dhe tatim paguesve të ndryshëm, shikohet në foto dokumentacionin e shkresave të lëndës, lexohet ekspertiza financiare e kryer nga eksperti Ukë Sadiku dt.13.09.2018, dhe shkresat tjera të bashkangjitura kësaj ekspertize, lexohet raport i ekspertizës së kryer nga ekspertët e TI-se nr.protokoli 156-FVTI-2016 dt.12.10.2016, dhe ekspertës së TI-se me nr.protokoli 191FVTI-2016 dt.24.10.2016 në Policinë e Kosovës Drejtoria e teknikës kriminalistike dhe raportit për plotësim të ekspertizës në fjalë me nr.të njëjtë të rastit dt.27.05.2019, është dëgjuar eksperti E. M. lidhur me sistemin “.....” dt.06.05.2019 dhe raporti i përpiluar me shkrim në përgjigjet e tij në pyetjet e parashtruara nga gjykata të dt.06.05.2019, dhe shkresat tjera të bashkangjitura këtij raporti.

Gjykata në shqyrtim gjyqësor i ka nxjerr të gjitha provat e duhura dhe pas vlerësimit të tyre të gjithanshëm, secilës veç e veç e në lidhje reciproke me provat tjera konform nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK dhe pas vlerësimit të tyre vërtetoi këtë gjendje faktike.

Se i akuzuari në Kuvendin komunal ka punuar edhe para dhe pas luftë, pas luftës ka punuar në një komision për vlerësimin e dëmeve nga lufta, pasi prej 1 vit e gjashtë muaj është shuar komisioni, i njëjti është transferuar në Drejtorin për financa në të cilin sektor ka punuar edhe para luftës kurse pas luftës nga viti 2002 deri në fillim të vitit 2010 në këtë drejtorat ka punuar në grupin e formimit të tatimit në pronë pranë KK-..., prej 2010 është transferuar në drejtorinë për kthim dhe komunitetet dhe atje ka punuar deri në maj të vitit 2012 dhe nga kjo kohe është transferuar në zyrën e prokurimit në KK-Pejë dhe atje ka punuar deri në fund të vitit 2015, nga kjo periudhë është transferuar në zyrë për kthim dhe komunitete dhe në këtë Drejtorin ka punuar deri në suspendim gjere me dt. 22.tetor.2016. Në të dy rastet, arsyeja e transformimit nga një drejtor në tjetrin, ka qenë se kanë filluar hetimet ndaj tij për çështje të njëjtë dhe herën e parë ka qenë i suspenduar 6-7 muaj dhe gjatë hetimeve në mungesë të provave prokuroria ka pushuar hetimet, herën e dytë i njëjti ka qenë i suspenduar 3 muaj, por prokuroria nuk ka filluar hetimet në mungesë provave. Në zyrë ka punuar me G. T. dhe Sh. R. të komunitetit rom. Ashtu që në periudhën kohore nga fillimi i muajit qershor 2016, në mënyrë të vazhdueshme e gjere me dt. 18.10.2016 në Pejë, duke qenë në pozitën e zyrtarit për komunitete dhe kthim në Komunën e, tejkalon autorizimet e tija ligjore me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete dhe personat tjerë, në atë mënyrë që përmes programit

„ , program ky i cili shërben për vjedhjen e fjalëkalimeve , merr fjalëkalimin e shfrytëzueses së kompjuterit M. L. dhe fjalëkalimin e shfrytëzuesit të kompjuterit G. T. zyrtar për Komunitet dhe Kthim në Komunën e , e duke shfrytëzuar kompjuterin e këtij të fundit , por edhe kompjuterin e tij personal , përmes programit, , hyn në sistemin kompjuterik të M. L.-zyrtare për tatim në prone në Komunën e , ashtu që gjatë periudhës së lartcekur ka arritur të shlyej obligimet tatimore të dëshmitareve, J. K., E. A., A. K., R. K., A. K., N. B., V. M., E. A., dhe V. B., duke i sjelle të njëjtëve, përfitim pasuror të kundërligjshëm , e duke i shkaktuar dem buxhetit të Komunës së në shumë prej 18.275.98 €, ndërsa në fillim të muajit qershor 2016, nga dëshmitari B. G., merr shumën e të hollave prej 170 €, për të shlyer obligimin e tij tatimor për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016, por të njëjtit tatimin në fjale nuk ia shlyen, ndërsa që të hollat në mënyrë të kundërligjshme i kishte përvetësuar për vetë.

Nga raporti njoftues i përpiluar nga drejtori i financave në Kuvendin Komunal J. A. dt.26.08.2016, gjykata ka vërtetuar se fillimi i hetimeve ndaj të akuzuarit , në Stacionin Policor në Pejë në NJHKEK ka filluar po nga drejtori i këtij drejtorati me dyshim se ka ndërhyrje të kundërligjshme në softwerin e tatimit në pronë duke i eliminuar, shlyer tatimet në pronë të disa tatim paguesve pa inkasuar fare shuma të caktuara, dhe se kjo ndërhyrje është bërë nga useri name - përdoruesi i zyrtarës M. L. e cila në kohën e ndërhyrjes ka qenë dhe ende ishte në pushim vjetor, dhe se si i dyshuar është personi H. K. i cili paraprakisht ka punuar në tatim në prone, i njëjti edhe me parë ka qenë i dyshuar për veprime të njëjta, por në kohën e kallximit të rastit punon në Drejtoratin për Kthim dhe Komunitete .

Nga vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshme të sendeve të dt.22.09.2016, gjykata ka vërtetuar se në zyrën e të akuzuarit është sekuestruar shtëpiza e kompjuterit ngjyre e zeze pa tip lloji, me barkod KPjKKP1-382-kodi 238.

Nga vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve me numër të rastit .2016-DE-300 dt.17.10.2016 gjykata ka vërtetuar se është konfiskuar shtëpiza e markës ngjyre e zezë e zyrtarës M. L. .

Nga vërtetimi mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve dt.19/10.2106, gjykata ka vërtetuar pas bastisjes së zyrës së të akuzuarit, janë konfiskuar dy telefona samsung dhe shtëpiza e kompjuterit Pentium 4 ngjyre e zeze me nr, barkodi KPjKKP1-379 e zyrtarit G. T., dhe një shtëpizë e kompjuterit Hewlet Pacard ngjyre e zeze me numër serik CZC40731SG me barkod KPjKKP1-700 e në prezencën e zyrtarëve të këtij drejtorati S. C. dhe Sh. R., kurse pas bastisjes në shtëpinë e të akuzuarit janë sekuestruar , një laptop i markës HP, një hardisk Hitachi, një hardisk Maxtor dhe tri CD.

Nga aktvendimi mbi shfrytëzimin e pushimit vjetor të nëpunëses M. L., gjykata ka vërtetuar se kjo zyrtare ka shfrytëzuar pushimin vjetor në kohëzgjatje prej 7 ditësh nga dt.07.07.2016 e gjere me dt. 15.07.2016

Nga aktvendimi i të punësuarit këtu të akuzuarit H. K. të dt. 24.12.2015 gjykata ka vërtetuar se i akuzuari i sistemuar në vendin e punës zyrtar i prokurimit, përkohësisht transferohet në vendin e punës zyrtar i lartë për të drejtat e komuniteteve dhe kthim në kuadër të Kuvendit Komunal në Pejë nga kryetari G. M., duke filluar nga dt. 28.12.2015 e gjere me dt.28.12.2016.Arsyeja e transferimit ishte se ndaj tij nga dt. 04.09.2014 kishin filluar hetimet për dyshime të njëjta dhe është pezulluar nga puna gjere me dt. 08.12.2014 kur prokuroria ka pushuar hetimet e me këtë kanë pushuar edhe arsyet e pezullimit.

Nga lista e obliguesve tatimor që u janë shlyer borxhet dhe nga kartelat financiare , gjykata ka vërtetuar se për periudhën kohore të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit , borxhet për tatim në pronë janë shlyer A., A. dhe R. K., V. M., N. B., J. K., E. A., dhe V. B. , e që është në përputhje të plote me ekspertizën financiar të kryer nga eksperti Uke Sadikaj.

Nga evidencat e hyrje daljeve të zyrtareve në objektet e KK-Pejë, për vitin 2016 për tre persona (dëshmia në CD 1), për të akuzuarin , dëshmitarët, M. L. dhe G. T., gjykata ka vërtetuar se në periudha të caktuara kohore, në kohën kur ka pasur aktivitetin programi , M. L. dhe G. T. në të shumtën e rasteve nuk kanë qenë në zyrë kurse H. K. po. Gjithashtu nga shtëpiza e G. T. janë regjistruar aktivitetet edhe me data 25.09.2016 ora 20.56.32, me 26.09.2016 ora 20.55.56, , me dt.03 dhe 07.10.2016 e regjistruar si Fakti se aktivitetet përmes removable disk nuk kanë regjistruar në rubrikën e parë kohën e regjistruar në shtëpizë, por vetëm kohën e aktivitetit apo qasjen e fundit , dëshmojnë se nga i akuzuari jo vetëm që ka pasur ndërhyrje edhe pas sekuestrimit të kompjuterit të tij por i njëjti ka pasur qasje edhe nga distanca në këtë shtëpizë. Aktiviteti i fundit nga kjo shtëpizë është dt. 13.10.2019 ora 11.39.33.

Nga raporti i rezulton se në gjirollogarin e të akuzuarit nga viti 2001 e gjere në vitin 2015 ka pasur të regjistruara deponime kesh prej 20 gjere në 500 € në shume të përgjithshme 12.440.69 € të cilat shuma i ka tërhequr kohë pas kohe dhe në kohën e sigurimit të këtij raporti gjendja ka qenë 00, gjykata vlerëson se këto të dhëna i referohen periudhës para vitit 2016 dhe nuk janë relevante lidhur me çështjen , nga raporti i Bank në xhirollogarinë e të akuzuarit rezulton që sipas të dhënave nga viti 2005 e gjere me dt.02.11.2016 shuma e përgjithshme e qarkullimit është 44.154.80 € kurse bilanci i gjendjes është 470.13 cent ,në këtë xhirollogari i akuzuari ka pranuar pagën nga Buxheti i Kosove kurse nga raporti i në gjirollogarin e të akuzuarit nuk rezulton asnjë transaksion, të tria këto i referohen xhirollogarisë të akuzuarit, nga këto prova gjithashtu nuk është siguru ndonjë dëshmi relevante. Nga raporti i Kompanisëpër thirrjet hyrëse dhe dalëse dhe raporti i kompanisëpër thirrje hyrëse-dalëse nuk është siguruar ndonjë dëshmi relevante. Andaj edhe gjykata në këto prova nuk e ka mbështet aktgjykimin.

Nga CD-ja mbi demin e shkaktuar buxhetit të Komunës dhe tatim paguesve të ndryshëm, komuna demin e ka vlerësua në shume prej 30.000 mije euro, gjykata në këtë prove nuk e ka mbështetë aktgjykimin nga se për demin e shkaktuar buxhetit të Komunës gjykata ia ka falur besimin e plote ekspertizës financiare.

Gjykata duke u bazuar në këto dëshmi –prova materiale, për të cilat nuk ka dilema për faktet të cilat janë vërtetuar, këtyre provave ju fale besimin e plote e të cilat janë në lidhje logjike dhe reciproke njëra me tjetrën si dhe me deponimet e dëshmitarëve, F. J., J. A. dhe M. L. dhe me raportet e ekspertizave të kryer nga eksperti financiar dhe ekspertet e TI-se , e të cilat do të elaborohen më poshtë .

Dëshmitarja **M. L.**, në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar, se është zyrtare për tatime në pronë në Drejtorinë e Financave në Kuvendin Komunal Pejë, përveç tjerash në kuadër të kompetencave të saj është edhe pagesa e tatimit në pronë e cila bëhet dy herë në vite, dhe at brenda komunës ku është banka e posaçme, por pagesa mundet të behet edhe në banka tjera, njoftimi për pagesë nga obliguesi tatimor, së pari shkon në Prishtinë në kuadër të Ministrisë së Financave tatimit në pronë, kurse tek këta pagesa ju vie e hequr – e shlyer, e nëse ndodh ndonjë gabim vjen pala me faturë dhe e verifikojnë në Prishtinë nëse ka ndonjë gabim.

Kompjuterin e ka ne emër te saj dhe fjalëkalimin e din vetëm ajo, pas ndodhjes se rastit kompjuteri i është konfiskuar nga policia drejtoria e krimeve ekonomike në Pejë. Për veç saj si zyrtar për futjen e të dhënave të tatim paguesve janë edhe zyrtaret M. T. dhe Y. S., ne rast nevoje kanë mundësi ta përdorin kompjuterin e njeri tjetrit por mund te kyqen secili me passwordin e vet. Dëshmitarja shpjegon se diku prej muajit maj qershor 2016, ka qene ne një udhëtim zyrtar , kurse ne korrik e gjere ne muajin shtator , disa herë ka marr pushim vjetor. kur është kthye nga pushimi në shtator, 2 dite pas, është njoftuar nga kolegët por edhe nga policia se ne kompjuterin e saj ka pas ndërhyrje, dhe policia kanë kërkuar me e nxjerr një gjendje të tatimit nga fillimi i vitit deri në fund të tetorit ku edhe kane konfiskuar kompjuterin e saj, menjëherë e ka njoftuar drejtorin për prezencën e policisë dhe i njëjti i është përgjigjur se është i njoftuar për rastin. Nuk ka njohuri se kolegët e zyrës nga kush kane kuptuar për ndërhyrje.

Dëshmitarja shpjegon se i është thyer passwordi dhe është keqpërdorë në mënyrë më brutale që mundet me ndodh, kompjuteri i saj, jo vetëm te dhënat zyrtare por edhe ato private , posa ka hy në kompjuterin e saj ka vërejtur se i është thyerdhe passwordi. Ka dyshuar ne një person por nuk mundë të deklarohet rreth kësaj, le të mbetet në përgjegjësin morale te personit në të cilin ka dyshuar. Të akuzuarin e njeh si kolegë të komunës. Ka njohuri se paraprakisht i njëjti ka punuar ne Drejtorinë e tatimit ne pronë kurse ne vitin 2016 i njëjti ka punuar ne Drejtorin për Komunitet dhe Kthim

User name i saj ka qene M. L. kurse Email adresa e saj ne vitin 2016 si zyrtare dhe ajo private ka qene “.....” kurse passwordi ka qene 123456, me qene se sistemi kërkonte shpesh qe te ndryshohet passwordi , passwordi i saj ka qene edhe dhe këtë e ka përdor ne sistemin, emailin privat e ka pas M. L., @hotmail.com te njëjtën e ka përdor edhe si zyrtar kurse passwordi ka qene, ky password ka qene pak__para se me ja marr kompjuterin, sa i kujtohet passwordi i mëhershëm ka qene data e lindjes së saj 21.05.1966. User name dhe passwordin e ka dit vetëm kjo, dhe pa i ditur këto dyja nuk mundesh me pas qasje ne sistemin Programinnuk e ka instaluar ne kompjuterin e saj. Është e vërtetë se një dite para se me ju marre kompjuteri nga policia e ka ndru passwordin.

Deri sa ishte ne pushim kompjuteri i saj ka qene i shkyqur, dhe nuk e kishte autorizuar askënd qe te punon ne vend te saj, dëshmitarja i referohet periudhave kohore kur ka qene ne pushime dhe ne kompjuterin e saj ka pasur ndërhyrje, për katër vite kur ka filluar punën në këtë drejtori, H. nuk ka qene asnjëherë ne zyrën e saj

Duke ju referuar dt..22.09.2016, ku ne kompjuterin e saj kishte ndërhyrje ne sistemin ku është bërë korrigjim i tatimit ne prone për personin E. A., nga ora 08.05 minuta, deklaroi se me koleget e zyrës ka qene ne byfe me pi kafe dhe kur është kthyer ne zyre kompjuteri ka qene i ndalur dhe kur e ka ndezur ka vërejtje se ka pas ndërhyrje dhe për këtë e ka lajmëruar drejtorin. Kur kishte probleme me kompjuterin është e vërtetë se ka kërkuar ndihme dhe i është drejtuar TI-se se Komunës , por TI gjate ofrimit te shërbimeve nuk ka pash shans te manipuloj me kompjuterin e saj nga se gjithherë ka qene aty prezent. .

Me rastin e vlerësimit te deponimit te kësaj dëshmitare, gjykata ia fal besimin e plote me vet faktin se e njëjta ne te gjitha fazat e procedurës penale ka deklaruar njëjtë , dëshmia e saj është ne përputhje me provat materiale dhe është ne lidhje logjike me deponimin e dëshmitareve, J. A., F. J., L. D. dhe me raportet dhe deklarimet e eksperteve te TI-se te dhënë ne shqyrtim gjyqësor.

Dëshmitari **G. T.**, gjate shqyrtimit gjyqësor deklaroi se punon ne zyrën për komunitete dhe kthim ne Kuvendin Komunal Peje, ne një zyre me te ka punuar Sh. R.dhe H. K. ky i fundit sa i kujtohet ne këtë zyre ka ardh ne vitin 2013-2014 nga Drejtoria për Financa, H. një kohe nuk ka pasur kompjuter dhe deri sa ja kane sjell kompjuterin, i njëjti ka pasur qasje ne kompjuterin e tij sa here ka dashtë, kur dëshmitari ishte prezent, kurse nuk ka njohuri se i njëjti a kishte qasje ne kompjuterin e dëshmitarit kur ai nuk ishte prezent, por një here deri sa ky nuk ishte prezentë, ne zyrë rastësisht ka qëlluar vajza e tij e cila e ka vërejte H.që ka qenë në kompjuterin e dëshmitarit. Deri sa ishte ne pushim vjetor policia ka konfiskuar kompjuterin e tij por nuk ka njohuri pse ja kane konfiskuar , për këtë është njoftuar nga shefi i zyrës S. C.. Sa ka njohuri H.i është konfiskuar kompjuteri nga policia, tre katër muaj pasi ja kane sjell, kompjuterri nuk ka qeni i ri por i përdorur. Nuk ka njohuri nëse ne kompjuterin e tij ka qene i instaluar programi , nuk ka njohuri për këtë program dhe as që din ta përdorë. I përdor vetëm aplikacionet Word dhe Exel, fjalëkalimin e kompjuterit te tij, përveç tij e ka ditur edhe H.te cilën ia ka treguar vet dhe e ka leju me punu ne kompjuterin e tij .

Dëshmitari **J. A.**, ne seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se te akuzuarin e njeh qe nga viti 2014 kur ishte duke punuar si zyrtar në zyrën e prokurimit, ne këtë periudhë ka qene një hetim ndaj tij për çështje të njëjtë, dhe ne mungese provash nga ana e prokurorisë është hedhe kallximi penal , dhe kryetari i komunës e ka transferuar në zyrën për komunitetet dhe kthim , të paktën me e larguar fizikisht prej objektit ku është bërë ndërhyrja e parë. Në zyrën për tatim ne prone sa ka njohuri ka punuar gjere ne vitin 2012. Dëshmitari punon si drejtor ne Drejtorin për Financa dhe buxhet dhe pikërisht hetimet ndaj te akuzuarit kane filluar nga ana e tij, nga se me qe i njëjti ka qasje te drejte për drejtë ne sistemin, ka vërejtur se ka pas ndryshime në pagesat e tatimit ne prone pa ndonjë vendim, respektivisht fshirja apo eliminimi i tatimit në pronë mundë me ndodhë vetëm nëse komisioni i ankesave si nivel i parë i ankimit në komunë merr vendim në raste të caktuar siç ka qenë ngarkesa e dyfishtë apo edhe në rast që ka pas ndonjë pagim në metra katror apo edhe diç tjetër mirëpo në çdo rast duhet të ketë vendim të komisionit në bazë të cilit ndërhyhet në kartela financiare të personave fizik apo juridik. Periudhat kohore kur ndodhin ndryshimet janë prej 1 mars deri 30 qershor, e paraparë me ligj e jo edhe në rast të ndodhjes së ndërhyrjes në korrik –shtator të vitit 2016 qe do te thotë se dëshmitari ka vërejtur se ka edhe ndryshime në një periudhë kur ka përfunduar afati ligjor për ndërhyrje në në muajin korrik –shtator dhe në bazë të kësaj ka vërejtur se diçka nuk është në rregull me eliminim pa ndonjë bazë ligjore të tatimit. Për këtë e ka njoftua kryetarin e komunës dhe shefin e krimeve ekonomike ku edhe e ka lajmërua rastin. Arsyeja qe si i dyshuar për te ishte këtu i akuzuari është se paraprakisht ka biseduar me zyrtarët tjerë të tatimit në pronë të cilët e kanë mohuar, kurse dyshimi tek i akuzuari ishte nga se njëjti edhe me pare ka qene si i dyshuar dhe kishte pas njohuri teknike për eliminimin e barrës tatimore-borxhit. Sipas dëshmitarit periudha kohore kur është bere ndërhyrja është korrik-tetor dhe këto ndryshime janë bere pa vendim, dhe demi qe i është shkaktuar Komunës është 30.000 €. Sa i kujtohet programi ka filluar te përdoret neper komuna nga viti 2011.

Këto ndërhyrje shlyerje te borxheve te tatim paguesve sipas dëshmitarit mund te rikthehen nga personat kompetentë operatorë të tatimit në pronë Y. S., M. T. dhe M.. Këto janë te vetmet borxhe qe nuk parashkruhen, te njëjtat nuk janë rikthyer për shkak të kompleksi tetit të lëndës dhe pengimit të hetimit të personave zyrtar, mendon se këto veprime do ti ndërmarrin pasi të mirët një vendim final lidhur me këtë rast nga gjykata.

Nga koha kur i akuzuari ka punuar , programi nuk ka pas ndryshim asgjë, i vetmi ndryshim është ligji i faljes së borxheve dhe se nuk ka pas avancim në borxh dhe nga janari i këtij viti është futur edhe tatimi në tokë.

Dëshmitari **L. D.**, ne shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se te akuzuarin e njeh si koleg ne K.K Peje , i njëjti punon si TI –i ne komune, me programin, këta si shërbim nuk kanë pas punë dhe nuk kanë asnjë lloj qasje, ai është shërbim që vie nga niveli qendror në këtë rast Ministria e financave është Web- shërbim, pra me fjalë tjera ky program nuk instalohet në kompjuter por përmes faqes së internet Explorer apo mozila mundesh me pas qasje në këtë program duke shënuar linkun në hapësirën e adresës – kërkuesit. Është program unik për të gjitha komunat, a mundë të ketë qasje nga distanca nuk ka njohuri, program është i dedikuar për Komuna në nivel të Kosovës. Vetëm TI-ja që është në departamentin e dëshmitarit ka privilegjet e administratorit të sistemit.

Dëshmitari deklaron se nuk është e vërtetë se ne muajin korrik ka shkuar ne zyrën e të akuzuarit, te asnjë nen punës nuk shkon nëse nuk e thërrasin paraprakisht, e lere me ti këtë thënë të akuzuarit largohu nga kompjuteri se kam me punu diçka ne te.

Me rastin e vlerësimit te dëshmimeve te këtyre tre dëshmitarëve gjykata iu fale besimin për faktet te cilat janë vërtetuar nga këto dëshmi e për te cilat nuk ka dilema, e te cilat janë ne lidhje logjike njëra me tjetrën e respektivisht me raportet dhe deponimet e eksperteve te dhëna ne shqyrtim gjyqësor e te cilave gjykata iu fale besimin e plote .

Dëshmitari **B. G.**, ne shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se ai posedon një Auto Shkollë ne emër te bashkëshortes se tij G. G., gjithashtu posedon edhe një shtëpi, dhe tatimet për këto paluejshmeri i paguan me rregull. Sa i përket vitit 2016 ne qershor ka shkuar ne Komunën e re ku behet pagesa e tatimit ne prone, me qene se ishte guzhve aty te dera e komunës e ka takuar H. K. n te cilin e njihte nga kryerja e shërbimit ushtarak, një herrit edhe fëmijët e H.ne auto shkollën e tij i kane kryer kurset për vozitje. I akuzuari i ka thënë ose prit ose unë ta kryej pagesën dhe ta sjelli faturën, i njëjti ia ka dhënë 160-170 €, pas dy tri ditësh i akuzuari ja ka sjelle pasqyrën dhe atë 00, kurse për fature nuk është i sigurt a ja ka sjell, herrave tjera pagesën për tatim ne prone e ka bere vetë. Dëshmitari sqarohet se nuk është e vërtet se shumen e te hollave qe ka cekur me larte te ja këtë dhënë H. për orët e mbajtura për vozitje te djalit te tij, e vërteta është se këto te holla ky ia ka dhënë H. për pagesën e tatimit ne prone.

Për faktet e vërtetuara nga ky dëshmitar gjykata ia fali besimin e plote nga se i njëjti ne te gjitha fazat e procedurës ka deklaruar njëjtë pa kurrfarë ndryshimi

Dëshmitari **Fatmir V. M.**, ne shqyrtim gjyqësor ka deklaruar, se e posedon një lokal dhe ne vitin 2016 ka qene ne emër te babait V. M. , kurse tani është ne emër te tij, tatimin ne prone e ka paguar personalisht dhe gjithnjë me rregull, dhe atë përmes sportelit qe gjendet ne Komune. Këtu te akuzuarin e njeh por me te njëjtin zyrtarisht nuk ka pas kontakt, e sidomos kur e ka bere pagesën e tatimit ne prone. Ne vitin 2016 nuk i kujtohet në cilin muaj e ka paguar tatimin ne prone.

Dëshmitari **A. K.**, ne seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar , se familja e tij posedon, hoteldhe disa dyqane tjera në Çarshi të gjatë, këto prona disa janë ne emër te tij, disa ne emër te vëllait te tij A. dhe disa ne emër te nenës R. K.. Deklaron se është para pagues i rregullt i pagesave te tatimit ne prone, pagesat edhe për anëtarët tjerë te familjes i bene personalisht, respektivisht i ka përmbushur edhe obligimet tatimore për vitin 2016 dhe

pagesat sipas dëshmitarit duhen te jene neper banka. Lidhur me pagesat për tatimin ne prone nuk ka pasur problem asnjë here me komunën, nga se, sa here e regjistron veturën e merr vërtetimin ne komunë dhe gjere tani asnjë here nuk ka pas problem. Te akuzuarin e njeh si qytetar te

Dëshmitari E. A., ne seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se si biznes ka një dyqan mishtoreje me emrin “.....”,shton se obligimet tatimore ne prone i kryen por ka edhe te pakryera. Tatimin ne prone mendon se e ka paguar për vitin 2016, dhe këtë obligim here e kryen personalisht e here djali i tij me qe lokalin ne fjale e ka barte ne emër te djalit. Te akuzuarin e njeh si qytetar të, i njeh edhe të parët e tij, kontakt me te nuk ka pasur asnjëherë por ka njohuri se është i familjes K. Pagesat zakonisht i ka bere te një femër ne sportel te Komunës.

Dëshmitari V. B., ne deponimin e tij ne shqyrtim gjyqësor ka deklaruar si biznes që 17 vite ka shitjen e mobileve , dhe obligimet tatimore i kryejnë kur vjen koha me i regjistrua kamionët, te akuzuarin e njeh si qytetar të dhe nuk ka njohuri ku punon e as qe ka pas kontakt ndonjë here me te . Nuk ka njohuri se me dt. 14.09.2016 ne kartelën e tij financiare te tatimit ne prone ti jete bere ndonjë korrigjim dhe ti është hekur ndonjë shumë e parave nga obligimi i tij tatimor, ndodh qe pesë herë në vit te paguan tatimin varësisht të kalimit të afatit të regjistrimit të kamionëve.

Ne mungese te sigurimit te prezencës se dëshmitarit J. K. sipas propozimit te mbrojtësit është dëgjuar djali i tij këtu **dëshmitari E. K. i cili** ne seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar qe si biznes ka argjendari dhe dyqanet i kane në Çarshi të Gjatë, përveç dyqaneve kane edhe dy banesa edhe pse këto prona janë ne emër te babait , pagesën e tatimit ne pronë zakonisht e bene personalisht dëshmitari. Te akuzuarin e njeh si qytetar të, dhe nuk ka njohuri se ku punon, nga i akuzuari asnjë here nuk ka kërkuar qe te ja kryej shërbimet për pagimin e tatimit në pronë. Gjer tani as ky e as babai i tij nuk janë ftuar qe te dëshmojnë lidhur me rastin.

Me rastin e vlerësimit te dëshmimeve te këtyre dëshmitarëve, gjykata nuk iu fali besimin për faktin se te njëjtat i konsideron si dëshmi deklarative dhe subjektive, te njëjtat janë ne kundërshtim me provat materiale respektivisht me kartelat financiare te tatimit ne prone , arsyeja e mos tregimit te vërtetës nga ana e dëshmitareve , sipas gjykatës qëndron ne atë qe të njëjtat mos ta inkriminojnë vetveten.

Dëshmitarët M. M. dhe R. B. te dy dëshmitarët deklarojnë se pronat nuk kane qene ne emër te tyre por te prindërve të tyre , asnjëri nga ta nuk kane veturë andaj edhe as për vitin 2016 e as me pare nuk kane bere pagese për tatim ne prone .Gjykata aktgjykimin nuk e ka bazuar ne dëshmitë e këtyre dy dëshmitarëve për vete faktin se deponimet e tyre janë irelevante lidhur me çështjen , nuk janë objekt akuze.

Dëshmitari **F. J.**, ne seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar, se hetimet preliminare lidhur me dyshimet e shprehura nga Drejtoria e financave-drejtori, kundër te akuzuarit kane filluar nga se personi në fjalë ka qenë subjekt i hetimit në krime ekonomike për të njëjtën vepër edhe dy herë më parë, ne vitin 2010 dhe 2014. Duke marr parasysh se ne te dy rastet e më parshme nuk janë bërë ekzaminimet përkatëse të shtëpizës së kompjuterit të personit në fjalë, të njëjtat në zyrën e tij me asistim edhe të sektorit për hetim të krimeve kibernetike ne Prishtine i është bërë sekuestrimi i përkohshëm i shtëpizës dhe e njëjta është dërguar për ekzaminim në drejtorinë e teknikës kriminalistike Policia e Kosovës Prishtinë. Duke marr parasysh se dyshimet kanë qenë se nga shtëpiza e kompjuterit të akuzuarit ka pas ndërhyrje

në programin, program ky në të cilin janë bazat e të dhënave për secilin tatim pagues në komunën e, në cilësinë e hetuesit të lëndës pasi ka pranuar CD-në në fjalë, ka shikuar se ne bazë të raportit në fjalë ekzistonin dyshime se nga kompjuteri i të akuzuarit përmes rrjetit ka pas ndërhyrje në programin në përdoruesin user name, në emër të M. L.t dhe në bazë të vlerësimit brenda kompetencave të tija si hetues janë pa edhe gjetur veprimet – ndërhyrje nga kompjuteri i ekzaminuar në ne user name e M. L.t që në këtë drejtim do ta shpjegojnë ekspertet. Po ashtu mund të lindë pyetja se si ka qenë një mundësi e tillë nga një kompjuterë që ka qenë 200 metra largësi në vendin ku ka qenë duke punuar M., në raportin e ekspertëve është cekur se si në kompjuterin-shtëpizën e të akuzuarit po ashtu edhe në shtëpizën e punonjës zyrtares së komunës tatimit në pronë M.s, ka qenë i instaluar programi i quajtur Fry, program ky i ndaluar në institucionin e zyrtares jo vetëm në Kosovë por gjithë botën, për arsye se përmes këtij programi barten të gjitha të dhënat nga shtëpiza në këtë rast të zyrtares M. L., në një adresë apo folder apo destinacion të caktuar, andaj ka lind dyshimi se qëllimi i akuzuarit përmes këtij programi ka mundësi sigurimin e fjalë kalimit – passwordit të zyrtares në fjalë në mënyrë që të ketë mundësi të qaset në përdoruesin e saj të programit me të cilin dyshohet se ka bërë edhe shlyerjen dhe ndryshimin e obligimeve tatimore të shumë tatim paguesve të komunës së, me këtë rast është marr edhe kompjuteri i kësaj zyrtare dhe shtëpiza e zyrtarit G. T. ku edhe janë dërguar në ekzaminim. Te shtëpiza e dëshmitarit G. T. zyrtar për komunitete dhe kthim ka dëshmuar se edhe nga shtëpiza në fjalë ka pas ndërhyrje në programin portax, të përdorueses M., po ashtu janë bërë ekzaminimet edhe të laptopit të sekuestruar përkohësisht në shtëpinë e të dyshuarit, janë konfiskuar 2 hardisqe të shtëpizave, janë sekuestruar edhe 3 CD me programe –udhëzues se si në një far forme të thyhen të gjitha passwordat. Si dëshmi shtesë për me dëshmuar veprën janë bërë edhe hyrje daljet e të dyshuarit H. K., dhe zyrtares M. , po thuhet shumicën e rasteve në kohën kur dyshohet se i dyshuari ka pas qasje ka ndërhy në përdoruesin e M.s janë bërë në kohën e mesditës 10 minuta para orës 12. eventualisht në orën 12.10 minuta. Në kohën kur ekzaminimi ka treguar lidhur me dyshimet për qasje në përdoruesin e M.s, realisht karta elektronike me të cilën dyshohen daljet dhe hyrjet në Komunë vërtetojnë se M. nuk ka qenë në Komunë në zyrën e saj dhe për shkak të intervalit kohor kur është kryer vepra i kanë kontaktuar zyrtarët e TI –së së komunës verbalisht mirëpo koha ka qenë e gjatë dhe kamerat nuk kanë mundur me siguru dhe ruajt imazhet në mënyrë që të vërtetohet nëse i akuzuari ka hy në Komunë ku zyrtarja M. nuk ishte në zyrën e saj.

Pse dëshmitari në raportet e tija ka konstatuar se H.i ka realizuar këto ndërhyrje në bazë të aftësive duke i përdorë aftësitë e tij të larta në teknologjinë informative, vlerësimi i tij është bërë në bazë të dyshimeve të cilat i dyshuari i ka bërë nga shtëpiza e tij me programet të cilat i shpjegoi me lartë realisht vetëm ekspertë – edhe hakerat mundë ti bëjnë këto. Pas analizimit të raporteve të ekspertëve, ka vërejt se ekspertët kanë konstatuar se i akuzuari në shtëpizën e tij dyshohet se ka përdorë programin dhe sa ka njohuri se programi portax është program i cili në rrjetin qeveritar ka mundësi me pas qasje jo çdo njëri mirëpo dyshon se i dyshuari duke pas parasysh përvojën shumëvjeçare i ka ndërmarr këto veprime, sa ka njohuri programi në fjalë nuk kërkohet me u instalu si program.

Dëshmitari sqaron se në raportet e tij është konstatuar se gjatë zbulimit të dhënave financiare për H.në dhe nuk ka transaksione kurse në xhiro llogarinë në periudhën prej 27.01.2014, deri me dt.10.09.2015, në xhiro llogarinë e H.ka pas qarkullim në shumë prej 12.440,66 euro dhe atë deponime kesh prej 50 gjerë 500 €, në këtë drejtim dëshmitari përmirësohet se raporti në fjalë i referohet viteve 2001-2015 dhe atë për 15 vite.

Dëshmitari ka njohuri se ne kompjuterin e M.s ka qenë i instaluar programi Fryr kurse në kompjuterin e të akuzuarit përveç këtij programi ka qenë i instaluar edhe programi Tor dhe programe tjera, dhe funksionet e këtyre programeve do ti sqarojnë ekspertët.

Me rastin e vlerësimit të dëshmisë se këtij dëshmitari gjykata ia fal besimin e plote për faktet për të cilat nuk ka dilema, dhe se dëshmia e këtij dëshmitari është në përputhje të plote me raportet e tij si dhe në lidhje logjike me provat materiale respektivisht me vërtetimet mbi sekuestrimet e përkohshme të provave, me evidencat e hyrje daljeve të zyrtareve në objektet e KK-Pejë dhe me raporte të ekspertizave të eksperteve të TI-se dhe deponimet e tyre të dhëna në shqyrtim gjyqësor si dhe në lidhje logjike me dëshminë e dëshmitarit J. A..

Nga deponimi i ekspertëve të TI-së, A. K. dhe nga raporti i tij i ekspertizës me numër të rastit 156- FVTI- 2016 dt.12.10.2016, dhe Sh. S. dhe raportit të saj me numër të rastit 191-FVTI-2016 të dt 31.01.2017,dhe raportit të detajuar të përpiluar me shkrim lidhur me ekspertizat e kryera nga ekspertet, gjykata ka vërtetuar se eksperti A. K.si objekt ekzaminimi të pajisjeve elektronike ka pasur provën D#1, D#1.1, dhe D#1.2 shtëpizë kompjuteri i markës HP me numër serik CZC4463WXY, dhe kjo prove në raportin e detajuar është shënuar me E#1, E#1.1 dhe E#1.2 e cila provë si tanësi nuk është ekzaminuar për shkak të mungesës së kapaciteteve harduerike brenda njësisë së tyre për procesimin e këtij disku, dhe D#2 shtëpizë e kompjuterit me numër serik KPjKKP1-382 dhe në raportin e detajuar kjo prove është shënuar si E#2 që ka të bëjë me shtëpizën e kompjuterit të akuzuarit .

Kurse ekspertja Sh. S. si objekt ekzaminimi të pajisjeve elektronike ka pasur provën D#1 shtëpizë e markës ngjyre e zeze me nr, serik CZC40731SG me barkod nr KPJKKP1-700 në emër të zyrtares M. L. që në raportin e detajuar kjo prove është shënuar me E#3 , provën D#2 shtëpizë Pentium 4 DUAL CORE ngjyre e zeze me barkod nr KPJKKP1-379 në emër të G. T. kjo prove në raportin e detajuar është shënuar me E#4, prova D#3 laptop i markës HP me numër serik 2CE1240FJY, ngjyre e zeze , laptopi i të akuzuarit, e në raportin e detajuar është shënuar me E#5, prova D#4 Hard Disku Hitachi me nr. serik S2TYVYLE , në raportin e detajuar është shënuar me E#6, prova D#5 Hard Disku Maxtor me nr. serik E1LPSEEE , në raportin e detajuar është shënuar me E#7, prova D#6 TelefoniNote 4 e të akuzuarit e në raportin e detajuar është shënuar me E#8, prova D#7 Telefoni mobilSHG 0880 po ashtu i akuzuarit, e në raportin e detajuar është shënuar me E#9, prova D#8, dhe kjo prove gjatë ekzaminimit rezultoi të jete tri CD dhe atë CD 3 PROGRAME e shënuar si prova D#8 .1, CD 1 PROGRAM e shënuar si prova D#8 .2 dhe CD pa mbishkrim e shënuar si prova D#8 .3 e në raportin e detajuar është shënuar me E#10 , E#10.1, E#10.2, dhe E#10.3

Sipas ekspertëve **programi** është program i cili ruan çdo të dhënë që shtypet në tastierën e përdoruesit të kompjuterit veçanërisht përdoret duke marrë informata konfidenciale (password dhe username). Instalimi i tij mund të bëhet duke pasur qasje direkte në kompjuter apo **edhe duke iu qasur nga distanca (qasje Remoter)**, ky program mund të menaxhohet edhe nga një kompjuter tjetër, janë disa versione disa mundësi me pas kontroll në një kompjuter nga një kompjuter tjetër e vetmja çështje është se dy kompjuterët duhet me qenë të lidhur në një rrjet dhe lidhja mes tyre bëhet në shumë programe të ndryshme Team Viwer që është i licencuar dhe patentuar. Pas instalimit nuk vërehet që është instaluar gjithashtu krijon raporte për të dhënat e futura përmes tastierës, kjo është pjesa kryesore që këtë program e bën të rëndësishëm. Programi pro starton në të njëjtën kohë me startimin e sistemit operativ Windows, është i padukshëm dhe gjatë punës në kompjuter nuk shihet ikona e tij përderisa ai ekzekutohet në prapavijë, dhe të dhënat e futura përmes tastierës

i ruan në formë të raporteve në tekst-fajlla, përmbajtja e të cilave organizohet në rreshta duke i ndarë me datë dhe kohë klikimet përmes tastierës, ruajtja e këtyre të dhënave më afër është përshkruar në tabelën e raportit të detajuar në faqen 9 nga 68. De instalimi i këtij programi mund të bëhet në mënyrë automatike ashtu siq është konfiguruar në fillim, p.sh. nëse sot kemi instaluar këtë dhe dëshirojmë që ai të de instalohet nga kompjuteri me datë të caktuar mjafton që në konfigurim të përcaktohet data dhe aktivizohet opsioni i tillë. Nuk ka mundësi që te ndërhysh në një kompjuter tjetër nëse ai është i fikur.

Programi CCLANER është program për kompjuterët që punojnë në sistemin operativ në Microsoft Windows, dhe instalimi i këtij programi kërkon që llogaria e përdoruesit të sistemit operativ Windows-it të jetë administrator apo cili do përdorues (User) përdorues tjetër me të drejta të administratorit që ka qasje në kompjuter. Instalimi bëhet nga “ Setup-i “ i programit dhe është në faqe(dritare) ku kërkohet miratimi i përdoruesit me “Next Agree” .Programi në fjalë shërben për pastrimin e diskut të kompjuterit nga fajllet, mbetjet e fajlleve të panevojshëm, fshinë gjurmët e dokumenteve që janë përdorur apo që janë fshirë nga përdoruesi, mbron privatësinë tuaj nga shumë aplikacione të sistemit operativ Windows, duke fshirë informacione rreth dosjeve që kemi përdorur, **de instalon programet**, menaxhon fajllet ”COOKIES” në kompjuter ashtu që pamundëson faqet e internetit ti përdorin për të gjurmuar vizitat tuaja.

Programi PravySoft Keylgger është program i krijuar për qëllime studimore e jo për keqpërdorim dhe me anë të tij ruhen kredencialet e shfrytëzuesit, (Username dhe Password) gjatë punës në kompjuter, për instalimin e këtij programi nuk kërkohet procedurat “Next Agree” dhe për aktivizimin e tij mjafton të klikohet në fajllin ekzekutiv PravySoftkeylgger Exe.

Programi TOR(The Onion Reouters) respektivisht shfletuesi i internetit, është program pa pagesë i cili ndihmon për të mbrojtur anonimitetin e përdoruesit gjatë përdorimit të internetit (fsheh IP-it , adresën e përdoruesit) programi TOR përbehet nga dy pjesë: Softweri, që mund të shkarkohet dhe që iu lejon të përdorin internetin në mënyrë anonime dhe rrjetin vullnetarë të kompjuterëve, (TOR Nodes) që bën të mundur që ky program të funksionoj, d.m.th. ky program mbron privatësinë e përdoruesit por nuk mund të fshihet fakti nëse është përdorur. Ky program instalohet nga Setup-i tij, apo mund të ekzekutohet nga fajllet e ekstraktuar pa pasur nevojë për instalim.

Team Viewer është program i cili mundëson qasje në distancë, prej një kompjuteri në një kompjuter tjetër të cilët gjinden në të njëjtin rrjet apo përmes internetit, që të mund të ketë qasje prej një kompjuteri në një kompjuter në distancë ky program duhet të jetë i instaluar në të dy kompjuterët, dhe për qasje nga distanca prej kompjuterit A në kompjuterin B nevojitet nr. Identifikues (ID) dhe fjalëkalimi (password) të cilat shfaqen në mënyrë automatike pas startimit të programit.

Sa i përket provës D#2, shtëpiza e kompjuterit të akuzuarit, tani emëruar si E#2, janë gjetur fajlle të programit të cilat fajlle janë fshirë (delete) të dhënat si emri i fajllit Shtegu, data e krijimit, data e modifikimit, data e qasjes, vlerat Hash për MD5 dhe Sha1 si dhe startuesi i fajllit (Y nënkupton që fajlli është fshirë kurse N nënkupton që fajlli nuk është fshirë) e të njëjtat janë të listuara në raportin e detajuar nga faqja 15 gjerë në faqen 17 nga 68. Në kohën e ekzaminimit të kësaj prove ky program nuk figuron si i instaluar.

Fajllet në numrat rendor 8, 11 dhe 13, janë të njëjte dhe rëndësi për sqarim të përmbajtjes parqet pikërisht ky fajll i cili është i emëruar si Pro 7 21 2016, ky fajll përmban aktivitete të regjistruara nga përdoruesi M. L. dhe bazuar nga të dhënat dhe vula kohore e fajllit, ky fajll është i kopjuar në provën E#2. Në ekzaminimin e provës E#2, edhe programi CCLEANER, është në listën e programeve të instaluara, programi ka qenë aktiv për përdoruesit administratorit, H. K.. KK. Pe.189. Eksperti shpjegon se nuk është arrit të nxjerrët ndonjëren që ka të bëjë me aktivitetin e këtij programi, respektivisht eksperti nuk ka mundur të sqaroj aktivitetin që është bërë në këtë program. Në këtë provë është gjetur folderi me emrin PravySoft dhe fajlli i PravySoft Exe. Follderi dhe fajlli janë të fshirë (delete) dhe rikthimi i tyre është bërë nga hapësira e pa lokuar e diskut, dhe nuk është arritur të gjendet ndonjë e dhënë që tregon për aktivitetin e këtij programi. Që të njëjtat janë paraqitur sikurse në raportin e detajuar të ekspertizës faqe 20 nga-68.

Programi Tor Browsers, në provën E#2 në volumin D në shtegun D, është program Setup i plotë dhe ekzekutiv. Aktiviteti i këtij programi nuk mund të lexohet.

Programi TeamViewer, në provën E#2 të ekzaminuar, janë gjetur katër (4) folldera të fshirë me emrin Team Viewer, follderat janë të zbrazët pa fajlle, nuk është arrit të gjendet ndonjë fajll për aktivitetin e këtij programi. Gjatë ekzaminimit të kësaj prove është konstatuar se në lidhje me programin, janë ndërtuar filtera duke përdorur fjalët Kyçe “.....” dhe eksperti ka arrit të rikthej këtë fajlle që përmbajnë fjalën “.....”.

Rëndësi për sqarim të përmbajtjes paraqet fajlli me emër Pro_7_21_2016.klg.txt në shtegun e Raport/Export/DLost Files/Key-1. Pjesa e fajllit e cila përmban fjalën “.....” është kjo. Që të njëjtat janë paraqitur sikurse në raportin e detajuar të ekspertizës faqe 21 nga 68. Kjo nënkupton se fjallit Pro_7_21_2016.klg.txt përmban aktivitet të përdoruesit “user” M..... në web platformën “.....”. Dritaret e hapura përmes shfletuesit “Google Chrome” kanë titullin: Login dhe- Departamenti i tatimit në Pronë v4.4.0.17.:<-<-<-<-<-<-bebe<-<-188915093693.20141REGJISTRIM I RI NR LENDES 620/20161170321789VLLADIMIR, MERITAMAKIMERITAMAKI Meritamaki 91890096057.

Fajlli linku.txt në shtegun E_Raport/Export/...../DLost Files/desk. Përmbajtja e fajllit është url link adres për programin Fajllin New Microcoft Offic Word Document .Docx në shtegun E_Raport/Export/...../DLost Files/key-1. Përmbajtja e fajllit është url adresë për programin Që të njëjtat janë paraqitur sikurse në raportin e detajuar të ekspertizës faqe 22 nga 68.

Kërkimi i bazuar në fjalën kyçe M. L.- janë ndërtuar filtra duke përdorur fjalën kyçe “ M. L.” dhe variacionet e tyre, p.sh “.....”, “.....” etj. Si rezultat nga prova E#2 kemi arritur të rikthejmë (të fshirë) fajllat e listuar si më poshtë (link file – short cat të dhënat e fajllave janë të paraqitura si në faqen 23 nga 68.

Kopja elektronike e fajllave është pjesë e raportit 156-FVTI-2016 shtegu i fajllave është E _Raport/Export/Mkafirete/Recent. Dhe këto janë të paraqitura ne faqen 23 nga 68.

Qasja nëpërmes rrjetës nga rezultatet e analizuara në programin IEF verzion 6.8.1.2634 , në mënyrë tabelare (Tabela 1) paraqesim gjurmët (ANG.log) e vizituar nëpërmjet rrjetit kompjuterik nga prova E#2 nëpërmjet kompjuterit i i cili ka si përdorues Mkafirete.Liman. Këto të dhëna janë pjesë e raportit elektronik 156-FVTI-2016/I_Raport/HTMLExport2016-10_11-31-05/Index.HTML Tek menyja Internet Explorer Main History. Me dt .20 korrik 2016

ora 08:35 :52 AM (UTC+2) nga përdoruesi nëpërmjet rrjeti kompjuterik është i vizituar fajlli shkronjat.Dox i cili gjendet në shtegun C\$/users/M...../Desktop/për shkronjat.Dox në kompjuterin e identifikuar me IP-in adres //10.153.68.148 me përdorues M.....

Sipas eksperteve Vula kohore (Timestamp) 07/20/2016 ka konfigurimin muaj dita viti ndërsa ora, shembull 06:35:52 AM është në UTC 0. Ora referente për regjionin tonë për këtë periudha kohore të vitit është UTC+2. Të dhënave nga tabela 1 qe kanë të bëjnë me orën time-(UTC) duhet shtuar +2 orë për të paraqitur për kohën lokale qe do te thotë ne rastin konkret ora ka qene 08:35 :52 AM, këto janë të paraqitura nga raporti i detajuar i ekspertizës ne faqe 24 nga-68

Tabela 1 – shtegjet e vizituara nëpërmjet rrjetit kompjuterik nga prova E#2 në drejtim të kompjuterit i cili si përdorues ka (Username) M....., tabela është paraqitur në ekspertize ne faqe 25 nga-68

Në mënyrë tabelare – Tabela 2 paraqesim gjurmët (Ang.log) e vizitave nëpërmjet rrjetit kompjuterik nga prova E#2, nëpërmjet përdoruesit (User) administrator dhe KK-pe189 në drejtim të kompjuterëve të cilët identifikohen me përdoruesin dhe G. T..

Nga prova E/2 përdoruesi ka pasur qasje në kompjuterin që identifikohet me përdoruesin (referojuni rreshtave në tabele 281-297, 301 -334,354-389,397-439448-455,471-479,500-528,553-558) ne faqe 26 nga 68.

Nga prova E#2 përdoruesi administrator ka pasur qasje në kompjuterin që identifikohet me përdoruesin M..... (referojuni rreshtave në tabele 88-118,131-144,152-165,193-210,153-267).

Nga prova E#2 përdorues administrator ka pasur qasje në kompjuterin që identifikohet me përdoruesin G. T. (referojuni rreshtave në tabele 120-126).

Me dt.08 Gusht 2016 ora 14:19:44 nga përdoruesi (prova E#2) nëpërmjet rrjetit kompjuterik është vizituar kompjuteri i cili në rrjetin kompjuterik identifikohet me IP-i adres 10.153.68.136

Me dt 12 gusht 2016 ora 13:09:11 nga përdoruesi (prova E#2) nëpërmjet rrjetit kompjuterik është vizituar kompjuteri – Log in _ Files i cili gjendet në shtegun C\$/@shell 32.dll-21813/M...../\$/@shell 32.dll,-21769/..... –Log in Files në kompjuterin e identifikuar me ID//10.153.68.136 dhe me përdorues M.....

Me dt 12 gusht 2016 ora 13:09:11 nga përdoruesi (prova E#2) nëpërmjet rrjetit kompjuterik është vizituar Folderi Docum-Soroptimist i cili gjendet në shtegun C\$/@shell 32.dll-21813/...../\$/@shell 32.dll,-21769/në Folderin Docum-Soroptimist kompjuterin e identifikuar me ID//10.153.68.136 dhe me përdorues

Tabela 2 që paraqet qasjen nga prova E#2 drejt kompjuterëve me përdorues dhe G. T. e që janë të paraqitura nga faqe 27- deri në 36 nga-68.

Prova E#3 nga raporti i detajuar (në raportin 191-FVTI-2016 shënohet si D#1-shtepiza e kompjuterit te zyrtares M. L.) pro-aktiviteti i gjetur në provën E#3 që ka të bëjë me

programin Frere Pro është se janë gjetur gjurmë të qasjes në katër tekst fajlle, emërimi i të cilave ka të bëjë me programin Pro. Bazuar në shtegun e qasjes të këtyre fajllave, këta fajlle janë hapur në këtë provë nga particioni C:/Prej User-it M..... e të cilët nuk janë gjetur fizikisht në këtë provë, por janë rikthyer .Janë të paraqitura në ekspertize në faqe 24 nga 68.

Programi Pro nuk figuron të jetë i instaluar në listën e programeve të instaluara në këtë kompjuter, megjithatë ka gjurmë që ka të bëjë me instalim dhe de instalimin e këtij programi. Instalimi psh.me dt.05.09.2016 dhe de instalimi me dt.06.09.2016. Programi Pravy Soft- në këtë provë është gjetur gjurmë që ka të bëjë me hapjen e një tekst Fajlli emërtimi i të cilit ka të bëjë me këtë program, pas instalimit të këtij programi, çdo gjë që shtypet në tastierë ruhet në fajllin e gjeneruar nga ky softwer me emër PravySoft.Txt. Në follderin ku gjendet programi. Prandaj në shtegun e hapjes të fajllit të mësipërm që është gjetur në provën E#3 ndodhet në User name e M...../documents/newfolder PravySoft/Key Logger/Pravy Soft.txt.Aktivitet që lidhet me këtë program është edhe Logu i ekzekutimit të këtij programi në këtë provë dhe është krijuar si “”. Pasonjë si në raport të ekspertizës faqe 38 nga 68. Gjithashtu janë gjetur dy linqe të cilat janë vizituar dhe të drejtojnë në web faqen e këtij softweri.

Nga programet CCleaner, Tor Browser, Team Viwer ne këtë prove nuk është gjetur ndonjë gjurmë.

Prova E#4 nga raporti i detajuar (në raportin 191-FVTI-2016 shënohet si D#2- shtëpiza e kompjuterit te G. T.). Gjurmët e gjetura në këtë provë që kanë të bëjnë me programin Pro është qasja në një teskt fajlli emërimi i të cilit ka të bëjë me programin Pro. Bazuar në shtegun e hapjes së këtij fajlli, ky fajll është hapur nga një USB drive. Emri i këtij tekst fjali i cili është hapur në këtë provë përmes USB drive me dt.06.09.2016 ora 12: 04: 29 është i njëjti për nga emri me atë i cili është hapur me dëshminë E#3 me dt.06.09.2016 ora 11: 59: 46.

Pravy Soft- nga ky program janë gjetur gjurmë që ka të bëjë me qasjen e një tekst fajlli emërtimi i të cilit ka të bëjë me këtë program Pravy Soft .txt.Pasonjë si në raport të ekspertizës faqe 39 nga 68.Ne këtë provë, program CCleaner rezulton të jetë i instaluar në listën e programeve të instaluara, aktivitet të programit CCleaner ka pasur me dt.24.08.2016, kurse nga programet Tor Browser dhe Team Viewer nuk është gjetur ndonjë gjurmë.

Një ndër programet tjetër me rëndësi është edhe Net Skin, i cili skanon rrjetin dhe liston IP-i adresat e kompjuterëve që gjenden në atë rrejt. Me dt.13.10.2016 bazuar në shtegun e Logut të mëposhtëm ne USB drive, F:/është bërë qasje në fajllin netscan.Zip përveç se iu është qasur këtij Zip fajlli, të dhëna tjera ne lidhje me këtë program nuk janë gjetur. P.sh për të kuptuar se për cilin program-skanues të rrjetit është fjala, versionin e tij etj, pasojnë si në raport të ekspertizës faqe 40 nga 68.

Qasja në-janë gjetur dy linqe që kanë të bëjnë me qasje në Linku.Txt-E e dhënë tjetër me rëndësi është hapja e fajllit linku.txt përmes USB-ve. USB-ja me emër, e cila është konektuar me këtë kompjuter me data të ndryshme, me nr. Serik 9431-12D0 dhënë nga e cila është hapur fajlli “Linku.Txt.”, ka qenë e konektuar gjithadhtu edhe në provën E#5. Nga prova E#5 gjithashtu është hapur fajlli “Linku.txt” përmes kësaj USB-së.

Prova E#5 në raportin e detajuar(raportin 191-FVTI_2016 shënohet si D#3 – laptopi i te akuzuarit) Emri i User-it në këtë provë është “.....”..... Pro- në provën E#5 nuk

figuron të jetë i instaluar. Gjithë aktivitetin që ka të bëjë me këtë program është i listuar. Bazuar në shtegun e logave, shihet që fajllat ekzekutiv janë hapur nga USB dhe kompjuter. Pasojnë si në raport të ekspertizës faqe 43 nga 68.

PravySoft-në këtë program është gjetur prova si program ekzekutiv ku ky program është i fshirë dhe është kthyer nga pjesa e paalokuar e diskut.CCleaner-ky program në këtë kompjuter rezulton të jetë i instaluar dhe me dt.08.10.2016 në ora 12:51:54 ka pasur aktivitet lidhur me këtë program.

Tor Browser- shfletuesi i internetit “ Tor Browser” në këtë provë është gjetur si fajll ekzekutiv i vendosur në disa folldera(lokalione).Pasojnë si në raport të ekspertizës faqe 44 nga 68.Aktiviteti i tij nuk është arritur të nxjerrët, kurse nga programi Team Viewer nuk është gjetur ndonjë gjurmë.

Të dhënat tjera me rëndësi në lidhje me provën E#5.Net Scan- në këtë provë është gjetur se përmes USB-së është hapur fajlli Net Scan.Zip.Fajlli “ New Microsoft Office Word Documet.Docx.”-, e dhënë tjetër me rëndësi është përmbajtja e këtij fajlli që lidhet me “.....” i cili në këtë kompjuter është krijuar me dt.27.09.2016, ora 18:26:05. Në faqen 46 nga 68 është paraqitur përmbajtja e fajllit si dhe vërejtja që ka të bëjë me atë fajll.

Fajlli “Linku.txt”-USB e cila është kyçur në këtë provë dhe nga e cila është hapur fajlli “linku.txt” rezulton të jetë njëjte me USB-në e kyçur e cila është e kyçur në provën E#4.

Prova E#6 si ne raportin e detajuar (në raportin 191-FVTI-2016 shënohet si D#4 Hard Disku Hitachi me nr. serik S2TYVYLE), Team Wiewer- nga ky program është gjetur një link (.....) fajll nga i cili shihet se është deinstaluar programi Team Viewer me dt.15.11.2011?????Ky link fajll është i fshirë, është kthyer nga pjesa e pa alokuar e diskut. Pasojnë si në raport të ekspertizës faqe 46 nga 68. Free Key Logger Pro, CCleaner, Pravy Soft, Tor Browser, nga këto programe nuk është gjetur ndonjë gjurmë.

Të dhënat tjera me rëndësi për provën E#6 është fajll “instalimi nga Best Computers.txt”.Përmbajtja e këtij fajlli që ka të bëjë me instalimin e programit “My Lan Viwer”, program i cili përdoret për skanimin e rrjetës për të listuar IP-it adresat e kompjuterëve që janë të lidhura në atë rrjet.

Për provën E#7 (në raportin 191-FVTI-2016 shënohet si D#5 Hard Disku Maxtor me nr. serik E1LPSEEE), kjo prove është ekzaminuar, dhe nga hard disku nuk është arritur të merret imazhi ngase nuk është njohur nga sistemi.

Për provën E#8 (në raportin 191-FVTI-2016 shënohet si D#6 është telefon “Samsung SM-N910c Galaxy Note 4 LTE” me një SIM kartelë, dhe një kartelë memoruese.) dhe për provën E#9 (në raportin 191-FVTI-2016 shënohet si D#7 telefon “Samsung SGHD-880” me dy SIM kartela, dhe një kartelë memoruese.) Nga këto prova nuk është gjetur ndonjë gjurmë që ka të bëjë me programet Pro, CCleaner, Pravy Soft, Tor Browser.

Për provën E#10 , E#10.1 E#10.2 dhe E#10.3 (në raportin 191-FVTI-2016 shënohet si D#8. D#8.1, D#8.2, D#8.3 tri CD), keto prova nuk kanë të bëjë me programet Pro, CCleaner, Pravy Soft, Tor Browser. Pasojnë si në raport të ekspertizës faqe 47 nga 68.

Gjykata nga deponimet e dy ekspertëve , raportet e ekspertizave të tyre dhe raportit të detajuar të tyre si gjurma të përbashkëta ka gjetur. Prova E#2 dhe E#3-gjurmët e programeve të njëjta në këto dy prova janë: Pro dhe Pravy Soft. Emrat e fajlleve të gjetura në provën E#2 janë të njëjta me emrat e fajlleve të cilat janë hapur në provën E#3.Fajlli Pro_7_21_2016.Klg.Lnk.te prova E#3 është krijuar me dt.22.07.2016, ora 12:01:08 ndërsa fajlli me emër Pro_7_21_2016.Klg.Txt. te prova E#2 është krijuar me dt.21.09.2016, ora 15:39:17, data e modifikimit(Last Writen) është 22.07.2016 ora 12:01:10. Kjo nënkupton se fajlli me provën E#2 është i kopjuar e që lidhet me datën e krijimit të fajllit në provën E#3.

Prova E#2 dhe E#4, në këto dy prova gjurmët e programeve të njëjta janë: Pro, CCleaner, Pravy Soft. Emri i fajllit i cili është gjetur në provën E#2 është i njëjtë me emrin e fajllit i cili është hapur në provën E#4.Pasojnë si në raport të ekspertizës faqe 48 nga 68. Linku me nr.rendor 484 i vizituar nga prova E#4 është i njëjtë me përmbajtjen e fajllit New Microsoft Office Word document.docx. i gjetur në provën E#2. Gjurma (Logu) New Folder/desk/linku.txt nga prova E#4 është e njëjta me fajllin e gjetur në provën E#2 i rikthyer nga hapësira e paalokuar.

Gjurmët e programeve të njëjta në provat E#2 dhe E#5 janë: Pro, CCleaner, Pravy Soft, Tor Browser.Pasojnë si në raport të ekspertizës faqe 49 nga 68.Fajlli në provën E#2 pason si në faqen 50 nga 68.

Prova E#2 dhe E#6 , gjurmët e programeve të njëjta në këto dy prova janë: përdorimi i programit Team Viewer.

Prova E#3 dhe E#4, gjurmët e programeve të njëjta në këto dy prova janë, Pro, Pravy Soft. Emri i fajllit i cili është gjetur në provën E#3 është i njëjta me emrin e fajllit i cili është hapur në provën E#4. Është gjetur gjurmë se në të dy provat ka pasur qasje në fajllin Pravy Soft.txt.

Në provat E#3 dhe E#5, prova E#3 dhe E#6 gjurmët e programeve të njëjta që janë përdorur këtu janë: dhe Pravy Soft.

Prova E#4 dhe E#5, gjurmët e programeve të njëjta që janë përdorur këtu janë: dhe Pravy Soft dhe CCleaner. Pasojnë si në raport të ekspertizës faqe 50 nga 68. USB-ja e cila është kyçur në provën E#4 dhe është hapur fajlli “linku.Txt” është e njëjtë me USB-në e cila është kyçur në provën E#5, nga e cila është hapur fajlli “Linku.txt”. USB-ja është e konektuar edhe në E#4 dhe E#5, gjithashtu numri serik i USB-se është i njëjtë 9431-12DO..

Emri i User-it në këtë provë LAPTOP është “.....”, gjithashtu USB-ja është me emër, e cila është konektuar në provën E#4 në kompjuterin e G. T. me data të ndryshme, që emri është emër i djalit të akuzuarit.

Provat E#4 - E#6, dhe E#5 –E#6- nuk është identifikuar ndonjë gjurmë e përbashkët. Pasojnë si në raport të ekspertizës faqe 51 nga 68.

Gjykata nga dëshmia e dëshmitarit-ekspertit E. M.te dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe nga raporti i detajuar në përgjigjet e tij në pyetjet e parashtruara nga gjykata , ka vërtetuar se i njëjti me profesion është Zv Menaxher i projektit të Zhvillimit të TI-se –Projektit 2, sipas tij sistemi është sistem informativ i cili përdoret për të administruar tatimin në prone

ne Republikën e Kosovës është sistem i aplikacionit ueb i centralizuar, zhvillohet mirëmbahet dhe operohet nga Ministria e Financave. Sistemin ne fjale përdoret nga Departamenti i tatimit ne Prone ne Ministrinë e Financave , nga Zyrtaret Komunal te Tatimit ne Prone dhe qytetaret te cilët mund ta shtypin faturën on-line nëpërmjet shërbimit e-fatura. Sistemi informativ është i qasshëm nga rrjeti qeveritar si dhe nga rrjeti i internetit qe i bie është i qasshëm nga jashtë institucionit shtetërorë . Zyrtaret Komunal mund ti qasen sistemit vetëm me linkun nga brenda rrjetit qeveritar , kurse për qasje nga jashtë duhet te ofrohet username dhe password i njëjtë me atë qe përdoret nga brenda rrjetit .

Qasja nga jashtë aplikohet për aplikacionin për anketim ne teren te cilin e përdorin anketuesit e zyrave komunale te tatimit ne prone .Linku nuk është i dukshëm as për anketuesit me qe i njëjti është i koduar ne aplikacionin qe ata e përdorin për anketim , kurse shërbimi e-fatura është i qasshme për publikun nëpërmjet internetit, dhe ky shërbim mundëson vetëm shtypjen e faturës online dhe asgjë me tepër .

Nëse qasen nga jashtë ne modulën, nëpërmjet username dhe passwordit valid, dhe nëse përdoruesi ka privilegje administrative ne sistem për te bere ndryshime atëherë mund te bëhen ndryshime edhe nga jashtë.

Sistemi 2 është ueb aplikacion qe përdoret për vlerësimin masiv te objekteve dhe tokave, ne krahasim me këtë te fundit sistemi 1 përdoret për te administruar , regjistrimin, tatimin dhe vjeljen e tatimit ne prone ..

Linku për 1 eshte <https://.....mf-rks.org/...../>, kurse per 2 linku eshte <https://.....mf-rks.org/.....2/>, dhe 1e ka edhe linkun për qasje nga jashtë rrjetit qeveritar e qe është <https://pts.mf-rks.org/...../>.

Lidhur me borxhin qe i është shkaktuar komunës për mes ndërhyrjes ne sistemin dëshmitari shpjegon se është i vetmi borxh qe nuk parashkruhet , borxhi mund te kthehet dhe nuk din se pse deri me tani nuk janë kthyer, pra sistemi e mundëson që me ndryshua borxhin bilancin e borxhit, zyrtari duhet me pas mbulesë nga një komisioni dhe sistemi e regjistron veprimin e përdoruesit çdo ndryshim i bilancit të borxhit regjistrohet

Nga ekspertiza financiare e punuar nga eksperti Uke Sadiku dhe deklarimi i tij ne shqyrtim gjyqësor , gjykata ka vërtetuar se tabela e paraqitur ne raportin e ekspertizës kolona 5 paraqet dëmin e komunës përmes ndërhyrjes ne sistemin, ndërsa kolona numër 8 është gjendja e sipas kartelave financiare për te gjithë këta tatim pagues dhe janë nxjerr datat kur është bere ndërhyrja ne sistemin dhe kjo gjendje e ndërhyrjes ne sistemin është ne përputhje me kartelat financiare. Sipas ekspertit lista e paguesve tatimor tek te cilët ka pasur ndërhyrje te palejueshme ne sistemin për periudhën 14.07.2016 e gjere me dt. 18.10.2016 emrat e cekur ne table , A. , A.dhe R. K., J. K. , N. B. , V. B. , V. M., E. A., kane qene obliguesit tatimor te cilëve nuk u janë shlyer obligimet tatimore ndaj Komunës me pagese reale këto pagesa janë fiktive. Komuna e është dëmtuar ne shume prej 18.275.98 euro , ky dem është vërtetuar përmes kartelave financiare kurse kush ka përfitua eksperti nuk ka mundur me vërtetu por sipas tij kjo mund te vërtetohet ne baze te dëshmive te dëshmitarëve. Në një rast është vërejt një diferencë ne shume prej 281.66 cent dhe është me rendësi me cek se ne reshtin e peste te tabelës numri 10 me numër te pronës 3172765 eksperti ka vërtetuar se këtë i është rikthyer gjendja si ne fillim para ndërhyrjes dhe ka ekzistuar mundësia qe ai dem kur është zbuluar me u rikthyer ne gjendje si para ndërhyrjeve , si dhe nga kush është rikthyer eksperti nuk ka njohuri por sipas tij ka mundësi te rikthehen edhe borxhet tjera, është e pa

qarte për ekspertin se çfarë qëllimi dhe përfitimi kanë pasur kompetentët të cilët nuk e kanë kthyer obligimin e tatimit në prone në gjendjen e mëparshme, kur në një rast veç është bërë, por kjo nuk është bërë për raste tjera e sikur të ishte bërë atëherë vërtetë buxheti i Komunës se nuk do të kishte kurrfarë dëmi. Sa i përket obliguesit tatimor B. G. për këtë person nuk i janë dhënë kartela financiare nga se nuk kishte të bënte me periudhën e cekur në dispozitiv të aktakuzës. Në tabele janë përshkruar obligimet që kanë qene në kartela para ndërhyrjes, pas ndërhyrjes dhe borxhi i mbetur pas ndërhyrjes. Sa i përket këtij të fundit gjykata ka vërtetuar nga dëshmitari B. G. i cili mes tjerash ka deklaruar se në muajin qershor të vitit 2016 ka shkuar në Komunën e re ku behet pagesa e tatimit në prone, me qene se ishte guzhvë aty të dera e komunës e ka takuar H. K. në cilin e njëjtit nga kryerja e shërbimit ushtarak, I akuzuari i ka thënë ose prit ose unë ta kryej pagesën dhe ta sjelli faturën, i njëjti ia ka dhënë 160-170 €, pas dy tri ditësh i akuzuari ja ka sjelle pasqyrën dhe atë 00, kurse për fature nuk është i sigurt a ja ka sjell. Në rastin konkret gjykata ka vërtetuar se qëllimi i të akuzuarit ka qene përfitimi i kundërligjshëm për vete nga se të njëjtit tatimin në fjale nuk ia shlyen, ndërsa që të hollat i kishte përvetësuar për vete.

Me rastin e vlerësimit të deponimeve të eksperteve, të TI, financiar dhe ekspertit 2, gjykata iu fal besimin e plotë për vete faktin se të njëjtat në lidhmëni reciproke njëra me tjetrën dhe në përputhje të plotë me ekspertizat dhe raportet e detajuara të këtyre ekspertizave, dhe provave tjera materiale si dhe dëshmitë e dëshmitarëve, M. L., J. A., L. D. dhe dëshmitarit F. J..

Për ekzistimin e veprës penale keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar duhet të plotësohen kumulativisht dy kushte, se pari personi zyrtar duhet ta ketë keqpërdorë detyrën zyrtare, dhe se dyti ta ketë bërë këtë me qëllim që të përfitoj çfarë do dobie për veti apo për ndonjë person tjetër apo të shkaktoj dem ndonjë personi tjetër ose të shkel seriozisht të drejtat e një personi tjetër.

Faktet e pakontestueshme e të mbështetura në prova të administruara në shqyrtim gjyqësor të cilave gjykata ua ka falë besimin janë si në vijim .

Nuk ishte kontestuese se i akuzuari H. K. ka qene zyrtar në Drejtorinë për Komunitet dhe Kthim në Kuvendin Komunal në Pejë, e që kishte autorizime të posaçme sikur që parashihet me nenin 120 par.2 pika 2.1 të KPRK-se.

Nuk është kontestuese se i njëjti pas luftës ka punuar në një komision për vlerësimin e dëmeve nga lufta, pasi që është shuar komisioni pas 1 vit e gjashtë muaj është transferuar në Drejtorinë për Financa në të cilin sektor ka punuar edhe para luftës, kurse pas luftës nga viti 2002 deri në fillim të vitit 2010 dhe në këtë drejtorat ka punuar në grupin e formimit të tatimit në pronë pranë KK-Pejë, deri sa punonte në këtë drejtorat i njëjti ka mbajtur disa trajnime para vitit 2009 si gjithë zyrtarët e komunave për departamentin e tatimit në pronë, prej 2010 është transferuar në drejtorinë për kthim dhe komunitetet dhe atje ka punuar deri në maj të vitit 2012, nga kjo kohe është transferuar në zyrën e prokurimit në KK-Pejë, dhe ka punuar deri në fund të vitit 2015, ku pastaj prapë është transferuar në zyrë për kthim dhe komunitete, i cili ka punuar deri me dt. 22.tetor.2016 ku është suspenduar deri në një vendim të gjykatës. Nuk është kontestuese se i njëjti ka qene i suspenduar për faktin se në vitin 2010 dhe 2014 ka qene i dyshuar për veprime të njëjta por në mungesë provave kanë pushuar hetimet ndaj tij, andaj edhe kjo është arsyeja e transformimit të njëjtit nga një drejtorat në tjetrin.

Gjykata ne mënyrë te pa kontestuar ka vërtetuar se i akuzuari deri sa ishte ne pozitën e zyrtarit për komunitete dhe kthim ne Komunën e, tejkalon autorizimet e tija ligjore, ne atë mënyrë qe përmes programit „ Free Keylogger „, program ky i cili shërben për vjedhjen e fjalëkalimeve , merr fjalëkalimin e shfrytëzueses se kompjuterit M. L. e duke shfrytëzuar kompjuterin e tij personal por edhe kompjuterin e këtu dëshmitarit G. T. , përmes programit,,, hyn ne sistemin kompjuterik te M. L.-zyrtare për tatim ne prone ne Komunën e, ashtu qe gjate periudhës qershor- tetor ka arritur ti shlyej obligimet tatimore te disa tatim paguesve te cekur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi .

Gjithashtu nuk është kontestuese se i njëjti kishte ne posedim një USB-i , ne te cilin USB , nga kompjuteri i tij kishte bartur linkun

Gjithashtu për gjykatën nuk është kontestuese se me këto veprime qëllimi i te akuzuarit ka qene përfitimi pasuror i kundërligjshëm , për vete dhe personat tjerë , personat e cekur ne dispozitiv te aktakuzës , te njëjtëve u ka sjellë përfitim ligjor duke iu shlyer obligimet tatimore ne prone e me këto veprime i ka shkaktuar dem buxhetit te Komunës se ne shume prej 18.275.98 €, ndërsa ne fillim te muajit qershor 2016, nga dëshmitari B. G., merr shumen e te hollave prej 170 €, për te shlyer obligimin e tij tatimor për gjashtë mujorin e pare te vitit 2016, por te njëjtit tatimin ne fjale nuk ia shlyen, ndërsa qe te hollat ne mënyrë te kundërligjshme i kishte përvetësuar për vete.

Nga këto te larte cekura, rezulton se gjykata i ka vërtetuar ne mënyrë te pakontestueshme faktet qe kane te bëjnë me kryerjen e veprës penale keqpërdorim i detyrës zyrtare nga neni 422 par.1 të KPRK-së dhe nuk ekziston asnjë rrethanë që e përjashton apo e zvogëlon përgjegjësinë penale të të akuzuarit, andaj edhe pretendimet e mbrojtësit në këtë drejtim janë të pabazuara.

Gjykata vlerësoi edhe mbrojtjen e te akuzuarit te dhëne ne te gjitha fazat e procedurës penale dhe mbrojtjes se tij pjesërisht ia fal besimin lidhur me vendin e punës dhe periudhën kohore ku ka punuar e sidomos për periudhën kohore nga viti 2002 e gjere ne vitin 2010 qe ka punuar ne drejtoratin për financa ne tatimin ne prone ne Kuvendin Komunal ne Peje, dhe gjate punës ne ketë drejtorat i njëjti ka vijuar trajnime lidhur me tatime ne prone, ia fal besimin edhe rrethanave të pohuara lidhur me arsyet e transformimit prej një drejtorati në drejtorat tjetër . Gjithashtu ia fal besimin se ne këtë drejtorin ka punuar me zyrtaret G. T. dhe Sh. R.. Ia fal besimin edhe pohimit te tij se i njëjti kishte ne posedim një USB-i ne te cilin e kishte bartur linkun “..... nga kompjuteri i tij, dhe se te njëjtën USB-i e kishte futur edhe ne kompjuterin e G. T. gjeja për te shikuar filma. Një herrit ia fal besimin lidhur me rrethanat për të cilat pohon se ne zyrën e tij policia ka konfiskuar një kompjuter KKP1/382 kodi 238, ngjyrë e zezë dhe 2 telefona celular, kurse në shtëpinë e tij nga policia janë konfiskuar 3 CD, nj llap top të markës HP, dy hard disqe, dhe se te njëjtat kane qene te tija.

Nuk ia fal besimin pohimit te tij se nuk e ka keqpërdor kompjuterin e G. T.dhe se nuk ka pas qasje ne te nga se nuk e ka dite passwordin e kjo për faktin se është ne kundërshtim me deponimin e dëshmitarit Gani i cili pos tjerash ka deklaruar se përveç tij passwordin e kompjuterit e ka dit edhe H.te cilin ia ka treguar vet dhe i njëjti ne prezence te tij shpesh e ka përdor kompjuterin, gjithashtu ka njohuri se H.ka përdor kompjuterin e tij edhe kur ai nuk ishte prezent dhe për këtë i ka treguar vajza e tij kur ajo një herë ka qene prezentë ne zyrë, kurse dëshmitari nuk ka qene prezent. Nuk ja fal besimin pohimit te akuzuarit lidhur me dëshmitarin B. G.n se te njëjtin nuk e ka pare nga kryerja e shërbimit ushtarak dhe nuk ka njohuri se çka punon ai, dhe nuk ka njohuri se në cilën auto shkollë djali i tij e ka mbajtur

kursin për vozitje. Kjo është në kundërshtim me dëshminë e dëshmitarit B. G., i cili ka deklaruar se ne qershor ka shkuar ne Komunën e re ku behet pagesa e tatimit ne prone, me qene se ishte guzhvë aty te dera e komunës e ka takuar H. K.n te cilin e njihte nga kryerja e shërbimit ushtarak, një herrit edhe fëmijët e H.ne auto shkollën e tij i kane kryer kurset për vozitje. I akuzuari i ka thënë ose prit ose unë ta kryej pagesën dhe ta sjelli faturën, i njëjti ia ka dhënë 160-170 €, pas dy tri ditësh i akuzuari ja ka sjelle pasqyrën dhe atë 00, kurse për fature nuk është i sigurt a ja ka sjell . Dëshmitari sqarohet se nuk është e vërtet se shumen e te hollave qe ka cekur me larte te ja këtë dhënë H.për orët e mbajtura për vozitje te djalit te tij e vërteta është se këto te holla ky ia ka dhënë H.për pagesën e tatimit ne prone.

Pohimit te akuzuarit se diku ne muajin korrik te vitit 2016 ne zyrën e tij ka shkuar TI-ja komunës L. D., ka kërkuar nga ky qe te largohet dhe te ja lëshon kompjuterin se ka me punua diçka ne te, nuk ia fal besimin nga se është në kundërshtim me deponimin e dëshmitarit Labinot i cili mohon të ketë qenë në zyrën e të akuzuarit për ta rregulluar kompjuterin e tij , nga se në zyrat e zyrtarëve shkon vetëm me kërkesë paraprake të tyre.

Gjithashtu edhe pohimet e te akuzuarit se ne kompjuterin e tij asnjë here nuk e ka instaluar programin Fry, e me këtë e mohon faktin se nga kompjuteri i tij dhe kompjuteri i G. T. te ketë ndërhyrë në kompjuterin e M. L. , këto pohime te akuzuarit janë ne kundërshtim me ekspertizat e ekspertëve te TI ku gjate ekzaminimit te kompjuterit te akuzuarit janë gjetur fajlle të programit të cilat fajlle janë fshirë (delete) kurse në kohën e ekzaminimit të kësaj prove ky program nuk figuron si i instaluar. Gjithashtu nga ekspertizat e TI te cilat janë elaboruar me larte ekspertet kane shpjeguar ndërhyrjet e te akuzuarit nga kompjuteri i tij dhe i G. T.ne kompjuterin e zyrtares M. L..

Deri sa ka punu ne Komunë, furnizimin me pajisje kompjuterike dhe teknike e ka bërë firma “.....” me pronar N. M.,dhe si serviser ka punuar edhe djali i tij M., edhe këtij pretendimi të akuzuarit nuk ia falë besimin nga se sipas ekspertizës së ekspertëve të TI-së dhe deponimit të tyre rezulton se emri i User-it në këtë provë LAPTOP është “.....”, gjithashtu USB-ja është me emër, e cila është konektuar ne provën E#4 në kompjuterin e G. T. me data të ndryshme dhe kjo USB-i ,qe emri i djalit te akuzuarit është

Andaj sipas kësaj gjykate një mbrojtje e tille ka qene e orientuar ne përjashtimin apo zvogëlimin e përgjegjësisë penale te tij.

Sa i përket pretendimeve të mbrojtësit se ne dispozitiv ceket se i akuzuari veprimet inkriminuese i ka kryer nga muaji korrik e gjere me dt. 18.10.2016 edhe pse me dt. 22.09.2019 te akuzuarit i është konfiskuar shtëpiza e kompjuterit nga hetuesit e krimeve ekonomike ne Peje, si është e mundur që ai të ketë ndërhyrë prapë , këto pretendime gjykata i vlerëson si të pabazuara nga se nga raportet e ekspertëve rezulton se ndërhyrje pas kësaj date ka pasur nga kompjuteri i G. T.të cilën e ka keqpërdor i akuzuari duke ndërhy ne sistemin protakx të përdorueses M. L. dhe atë me data të ndryshme ajo e fundit me dt.13.10.2016.

Mbrojtësi pretendon se pasi qe programi „ Freekeylogger,, është gjetur ne kompjuterin e zyrtares M., e sipas ekspertit te TI-së A. K.ky program instalohet drejte për drejt ne kompjuter, si dhe duke pasur parasysh se zyrtarja M. ka deklaruar se nuk din as çka është ky program e as për çka shërben e asnjëherë këtë program nuk e ka instaluar ne kompjuterin e saj si dhe duke pasur parasysh deklarimin e saj se i akuzuari nuk ka qene ne zyrën e saj , dhe se i njëjti vendin e punës e ka ne një ndërtesë tjetër nga ajo ku e ka zyrtarja M. , parashtrohet pyetja se si i akuzuari e instaloj këtë program kur thuhet se ky program ne kompjuterin e

zyrtares është instaluar dhe de instalu disa here, edhe këto pretendime te mbrojtësit janë te pa bazuara me vet faktin se ekspertet e TI kane deklaruar se programi ne fjale përveç qe instalohet drejte për drejte ne kompjuter instalimi i tij mund të bëhet edhe duke iu qasur nga distanca (qasje Remoter), ky program mund te menaxhohet edhe nga një kompjuter tjetër, janë disa versione disa mundësi me pas kontroll në kompjuter tjetër nga një kompjuter tjetër e vetmja çështje është se dy kompjuterët duhet me qenë të lidhur ne një rrjet dhe lidhja mes tyre bëhet në shumë programe të ndryshme Team Viwer etj.

Gjithashtu mbrojtësi pretendon qe sipas ekspertit te programit 2 E. M., zyrtarët komunale te tatimit ne prone nuk janë te pajisura me linkun e qasjes nga jashtë te njëjtit janë te njoftuar vetëm me linkun e qasjes nga brenda rrjetit qeveritar , qasja nga jashtë aplikohet për aplikacionin për anketim ne tersi te cilin e përdorin anketuesit e zyrave komunale te tatimit ne prone, ky pretendim i mbrojtësit është i pa bazuar nga se sipas ekspertit E. M., ne modulim mund te këtë qasje nga jashtë nëpërmjet user name dhe passwordit valid dhe nëse përdoruesi ka privilegj administrative ne sistem për te bere ndryshime atë here mund te behën ndryshime edhe nga jashtë .

Gjykata duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, për te akuzuarin i ka vlerësuar te gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese ne kuptim te nenit 73 par.1 te KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për te akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti më parë kishte pasur sjellje korrekte dhe nuk kishte rene asnjëherë ne konflikt me ligjin, sjelljen e tij korrekte gjate shqyrtimit gjyqësor, se është baba i tre fëmijëve dhe mbajtës i vetëm i familjes, të cilat gjithashtu kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana favorizuese, kurse si rrethanë rënduese gjykata pati parasysh rrethana se këto veprime në kohën e fundit janë bërë dukuri të shpeshta në Kosovë gjë që po dëmton imazhin e shoqërisë Kosovare, ne prezencën e këtyre rrethanave lehtësuese dhe renduese, gjykata te akuzuarin e ka gjykuar për veprën penale qe i vihet ne barre me dënim si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi me te cilën do te arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Duke i vlerësuar kështu te gjitha rrethanat e parashikuar me nenin 73 par.1 te KPK-se, Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar te akuzuarit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale te tij dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit te dënimit ne pengimin e te akuzuarit ne kryerjen e veprave penale ne te ardhmen por ai do te ndikoj edhe si preventive gjenerale për personat tjerë qe te përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 41 te KPK-se .

Komfor nenit 83 të KPRK-së, ne dënimin e shqiptuar te akuzuarit i është llogaritur edhe koha e kaluar ne paraburgim dhe arrest shtëpiak.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është i bazuar ne lartësinë reale te shpenzimeve te shkaktuara për zhvillimin e këtij procesi penal, prandaj gjykata duke u bazuar ne nenin 450 te KPPRK-se te akuzuarin e obligoi ne pagimin e shpenzimeve procedurale dhe te paushallit gjyqësor.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë komfor nenit 39 par.3 nën par. 3.2 të Ligjit nr. 05/L-036

Te akuzuarit gjykata nuk ia shqiptoi dënimin plotësues urdhrin për kompensim te demit , për vet faktin se nga ekspertiza financiare është vërtetuar se ne një rast është rikthyer borxhi dhe

mund te rikthehen edhe borxhet tjera dhe sikur te ishin rikthyer atëherë komuna nuk do te ketë kurrfarë dëmi , ne këtë drejtim dëshmitari J. A. dhe eksperti TI-se 2 E. M. kane deklaruar se borxhi-dëmi qe i është shkaktuar komunës për mes ndërhyrjes ne sistemin, është i vetmi borxh qe nuk parashkruhet , borxhi mund te rikthehet, eksperti E. M. nuk ka njohuri se pse deri me tani nuk janë rikthyer, nga se sistemi e mundëson që me ndryshua borxhin bilancin e borxhit, zyrtari duhet me pas mbulesë nga një komisioni, kurse sipas dëshmitarit Jeton të njëjtat nuk janë rikthyer për shkak të kompleksitetit të lëndës dhe pengimit të hetimit të personave zyrtar mendon se këto veprime do ti ndërmarrin pasi të mirët një vendim final lidhur me këtë rast nga gjykata.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil u murr në mbështetje të nenit 463 të KPPRK-së me te vetmin qellim nëse eventualisht ndonjë borxh i ndonjë tatim paguesi nuk mund te rikthehet.

Nga arsyet e cekura me larte dhe me zbatimin e nenit 365 te KPPRK-se është vendosur si në dispozitiv te këtij aktgjykimi .

Duke u bazuar ne nenin 368 te KPPK-se, Gjykata palët ne procedure i njoftoi me paralajmërimet qe shoqërojnë aktgjykimin.

**GJYKATA THEMELORE PEJË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,
P .nr. 106/17 të dt.02.12.2019 i përpiluar me dt.03.01.2020**

Sekretarja Juridike
Shpresa Kërnja d.v

Kryetarja e Trupit Gjykues
Lumturije Muhaxheri d.v

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës se Apelit ne Prishtinë, e përmes kësaj gjykate